



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë
Ekonomike”**

ofruar nga

Universiteti Europian i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Ezmolda Barolli

Dr. Odeta Shkreli

Qershor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Informatikë Ekonomike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS, Nr. 226, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	181 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	"Informatikë Ekonomike" 2021-2022: 14 PAE/0 PAK 2022-2023: 22 PAE/8 PAK 2023-2024: 33 PAE/7 PAK "Business Informatics" 2021-2022: 10 PAE/1 PAK 2022-2023: 11 PAE/4 PAK 2023-2024: 14 PAE/6 PAK
18	Numri i studentëve:	"Informatikë Ekonomike" dhe "Business Informatics" 2021-2022: 40 studentë 2022-2023: 87 studentë 2023-2024: 104 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin Europian të Tiranës. Ky program realizohet me 181 kredite, në gjuhën shqip dhe anglisht, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, 6 semestra, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në "Informatikë Ekonomike", referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Hapja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 226, datë 19.07.2021. Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut për specialistë në fushën e Informatikës Ekonomike.

Qëllimi i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është të pajisë studentët me njohuritë dhe konceptet bazë formuese në fushën e Informatikës Ekonomike, ti përgatisë ata si specialistë të informatikës së aplikuar në biznes, në ndërtimin e bazave të të dhënave, rrjetave kompjuterike, të programeve kompjuterike, etj. Ky program studimi tenton të rrisë aftësitë e punës së pavarur të studentëve, të menduarit kritik si dhe pozicionimin e tyre aktiv në tregun e punës. Programi refleton një strukturë mësimore të mirëstrukturuar mbështetur në eksperiencën e gjatë akademike dhe profesionale të UET, në përvojat e alumni-t të programeve të ndryshme që ky institucion ofron, si dhe të ekspertëve të fushës me të cilët UET bashkëpunon. Programi është i strukturuar në përputhje me standardet kombëtare të arsimit të lartë dhe ofron mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta dhe të specializuara në fushën e Informatikës Ekonomike. Programi i studimit u jep mundësi të shumta punësimi studentëve si specialistë të teknologjisë së informacionit në sektorin bankar, të sigurimeve, në institucione financiare, statistikore, në proceset e biznesit, marketingut dixhital, programues, zhvillues të web-it, ndërtues rrjetash kompjuterike, etj.

Ky raport i përgatitur nga ana e Grupi të Vlerësimit të Jashtëm ka për qëllim vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti European i Tiranës ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për herë të parë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" me shkresën datë 02.11.2023, regjistruar në protokollin e ASCAL Nr. 405 Prot., datë 03.11.2023.

Gjatë procesit të vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga **Prof.Dr. Ezmolda Barolli dhe Dr. Odeta Shkreli**, është mbështetur nga Msc. Arbri Ndreka, Koordinator Teknik i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Në bazë të vlerësimit kanë qënë kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit "Bachelor" në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri.

Në përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), GVJ ka analizuar gjetjet e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) bashkë me anekset si dokumentacion mbështetës dhe evidencat e përgatitura nga strukturat përkatëse. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj. Gjatë analizës së RVB, janë evidentuar disa pyetje e komente të cilat përbënë bazën e diskutimeve në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion. Gjatë kësaj vizite, GVJ u takua me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Përgjegjësen e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut si departamenti përgjegjës për këtë program studimi, Përgjegjësen e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si departamenti që lidhej ngushtësisht dhe mbështetëse me staf akademik për realizimin e këtij programi studimi. Gjithashtu GVJ zhvilloi takime dhe diskutime me GVB, stafin akademik dhe studentët e këtij programi, përfaqësuesit e Drejtorisë së Standardeve dhe Cilësisë, të Zyrës së Burimeve Njerëzore, të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit dhe të Sekretarisë Mësimore, gjatë diskutimit me të cilët u sqaruan çështjet sipas pyetjeve të përgatitura më parë nga GVJ. Gjithashtu, përmes vizitës në institucion, GVJ është njohur më nga afër me infrastrukturën fizike dhe mësimore, vizitoi laboratorët, auditorët, bibliotekën, për të parë nga afër përshtatshmërinë e tyre me standardet cilësore të mësimdhënies.

GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për organizimin e takimeve dhe vënien në dispozicion të çdo dokumenti apo informacioni të kërkuar për këtë proces.

Më datë 22.05.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.89/12 Prot., datë 22.05.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 29.05.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.118/3 Prot., datë 29.05.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.



GVJ, pasi u njoh me komentet e IAL-së për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

Standardi II.1 / Kriteri 1

Përgjigje nga GVJ: Përmbajtja e Kriterit 1 mbi të cilën ka sqaruar/komentuar institucioni nuk përputhet me atë të shkruar nga ekspertët në RVJ.

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.

Standardi II.2 / Kriteri 1

Përgjigje nga GVJ: Bazuar në Planin Mësimor të këtij programi studimi, vlerësojmë se ky program ka një natyrë ndërdisiplinare dhe bashkëpunimi midis departamenteve apo fakulteteve të institucionit është me vlerë dhe i rekomandueshëm. GVJ rekomandon që njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi të mbajë peshën kryesore të këtij programi për të qenë në koherencë me nevojat e programit dhe përmbushjen e objektivave të tij.

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.

Standardi II.4 / Kriteri 5

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson sqarimin e GVB dhe përpjekjet e institucionit për të qenë në përputhje me kriterin për të përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit në lëndët e këtij programi studimi, gjë që e shikojmë në pjesën më të madhe të tyre. Kjo gjë është vlerësuar nga GVJ, megjithatë:

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.

Standardi III.5 / Kriteri 3

Përgjigje nga GVJ: GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni si dhe sqarimet dhe komentet e GVB, konstaton se në lidhje me Kriterin 3 të Standardit III. 5, institucioni ka hartuar rregullat për hartimin e tezës së provimit final, njohuritë që duhet të testohen dhe peshën e secilës tipologji të lëndëve. Megjithatë rekomandimi i GVJ në këtë pikë ka qenë për hartimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm që administron provimin final.

GVJ konkludon që rekomandimi i saj ndryshon dhe RVJ ndryshon në këtë pikë.

Standardi IV.1 / Kriteri 1

Përgjigje nga GVJ: Përgjigja për këtë koment është e njëjtë me përgjigjen e dhënë nga GVJ në Standardin II.2 / Kriteri 1.

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.

Standardi IV.3 / Kriteri 1

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson përdorimin e sistemit LMS për lehtësimin e aksesit në materialet mësimore dhe e konsideron atë një mjet të dobishëm për organizimin dhe mbështetjen e procesit mësimor. Megjithatë, LMS nuk mund të zëvendësojë funksionin e bibliotekës si burim i strukturuar dhe i aksesueshëm institucionalisht për literaturën bazë akademike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se një pjesë e literaturës së detyrueshme nuk është e pranishme në fondin e bibliotekës. Në mungesë të saj në bibliotekë, mbetet e paqartë nëse dhe si sigurohet qasja e plotë dhe e ligjshme në këto burime nga të gjithë studentët. Për këtë arsye, GVJ i qëndron rekomandimit për pasurimin e bibliotekës me literaturën përkatëse në format fizik ose elektronik, në mënyrë që të garantohet akses i qëndrueshëm dhe i barabartë në burimet mësimore për të gjithë studentët.

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.

Standardi IV.4 / Kriteri 6


Përgjigje nga GVJ: GVJ ka shqyrtuar faqen zyrtare dhe vlerësimi është bërë mbi bazën e informacionit të publikuar në të. Megjithatë jepen të dhëna të përgjithshme mbi programin në tërësi, informacioni mbi përmbajtjen e programit mësimor kufizohet në një listë lëndësh dhe kreditesh, që për një student potencial ose individ jo të fushës mund të jetë i pamjaftueshëm për të kuptuar realisht çfarë mbulon secila lëndë. Për këtë arsye, GVJ i qëndron rekomandimit për një pasqyrim më të detajuar të programit mësimor, duke i ndihmuar studentët të marrin vendime të informuara për ndjekjen e programit.

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.

Standardi V / Kriteri 1

Përgjigje nga GVJ: GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për të reflektuar rekomandimet e dhëna dhe nxit vijimin e përpjekjeve për pasqyrimin sa më të plotë, të qartë dhe të përditësuar të informacionit në faqen zyrtare, në lidhje me kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes, përparimit akademik, transferimeve dhe njohjes së studimeve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Për këtë arsye:

GVJ konkludon që RVJ nuk ndryshon në këtë pikë.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti European i Tiranës (UET) është një IAL me një përvojë më shumë se 15 vjeçare në arsimin e lartë dhe ofron një sërë programesh studimi të nivelit bachelor, master dhe doktoraturë të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare. (https://uet.edu.al/rreth-uet/). Misioni i UET është "të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve, një qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore - politike, ekonomike dhe juridike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë, si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor në drejtimet specifike ku zotëron potencial". Në Planin Strategjik 2021-2025 UET shprehet se Vizioni i tij është "kthimi i UET në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal". (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik 2021-2025). GVJ konstaton se institucioni në mbështetje të misionit dhe vizionit të vet, kontribuon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Statuti i UET përcakton qartë në Nenin 6, qëllimin, objektivat, vizionin dhe misionin e institucionit të cilat synojnë ta bëjnë këtë institucion lider në sistemin universitar, duke synuar një cilësi të lartë dhe standarde ndërkombëtare në prodhimin e dijes dhe të njohurive shkencore dhe akademike. (Evidenca Nr. 2. Statuti i UET). UET ka në planet e veta strategjike mësimdhënien me në qendër studentin, ofrimin e edukimit cilësor dhe pajisjen e studentit me aftësitë profesionale dhe disiplinën intelektuale. (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik 2021-2025). GVJ konstaton se në këtë linjë janë hartuar dhe ofrohen programet e studimit, një nga të cilët është Bachelor në "Informatikë Ekonomike", i cili ofrohet në përputhje me Statutin e institucionit dhe planet e veta strategjike. (Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit të Studimit BA Informatikë Ekonomike).

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Sipas Rregullores së programit (Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit të Studimit BA Informatikë Ekonomike), ai ka si objektiv përgatitjen e studentëve me njohuri dhe koncepte të disa disiplinave të ndërthurura, të tilla si menaxhimi, financa, marketingu dhe informatika duke qenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës për ndërthurjen e teknologjisë së informacionit në të gjitha disiplinat ekonomike. Në këtë kuadër ky program vjen si një pjesë organike e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në përputhje me drejtimin akademik të tij dhe të vetë institucionit. GVJ gjithashtu konstaton se programi ecën në të njëjtën linjë me Planin Strategjik të UET 2021-2025, ku theksohet se institucioni i kushton një vëmendje të veçantë ndërdisiplinaritetit si kontribues kryesor në avancimin e dijes, inovacionit dhe kreativitetit (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik 2021-2025). GVJ konstaton gjithashtu se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofrohet në përputhje me Rregulloren e tij (Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit të Studimit BA Informatikë Ekonomike) e cila mbështetet tek Statuti (Evidenca Nr. 2. Statuti i UET) dhe Rregullorja e institucionit (Evidenca Nr. 5. Rregullore e UET).
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se UET ka një përvojë të gjatë në fushën e arsimit universitar, duke ofruar të gjitha kapacitetet dhe garancitë për të qenë një ishull ekselence dhe për t'i dhënë studentëve, pedagogëve, kërkuesve shkencorë, një hapësirë bashkëpunimi për transferimin e dijes dhe realizimin e projekteve shkencore (https://uet.edu.al/rreth-uet/). Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Stafi akademik i të dy departamenteve është i kualifikuar dhe me ekspertizë në përputhje me fushën e këtij program. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se institucioni e ka përvojën dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB, Tabela 1, 2, 7).
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në	Sipas Planit Strategjik të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, theksohet se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut përgjegjës për këtë program studimi, synon të ruajë dhe garantojë përputhshmërinë e



përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	kurrikulës së programit të studimit me njohuritë dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e aplikimeve informatike në ekonomi, aftësimin e studentëve me njohuri teorike dhe praktike, në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, në nivel kombëtar dhe rajonal me profesionistë të fushës së ekonomisë orjentuar nga problemet e informatikës (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit). Programi parashikon studime në fusha të informatikës të tilla si: gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmika, struktura e të dhënave, zhvillimi i web-it, etj., të kombinuara me njohuritë të tjera specifike të fushës së ekonomisë si statistikë në dy nivele, matematikë e zbatuar në ekonomi, menaxhim, marketing dhe financë, etj. Duke pasur një natyrë ndërdisiplinare, fusha e ekonomisë mbulohet nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ndërsa për të mbështetur mbulimin e fushës së informatikës, departamenti përgjegjës bashkëpunon me të tjera departamente të IAL, siç është Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, i Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni në mbështetje të misionit dhe vizionit të vet, kontribuon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike kulturore kombëtare. GVJ konstaton se në këtë linjë janë hartuar dhe ofrohen programet e studimit, një nga të cilët është Bachelor në Informatikë Ekonomike, i cili ofrohet në përputhje me Statutin e institucionit dhe planet e veta strategjike. Gjithashtu programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofrohet në përputhje me Rregulloren e tij e cila mbështetet tek Strategjia për zhvillimin e institucionit. UET ka një përvojë të gjatë në fushën e arsimit universitar, duke ofruar të gjitha kapacitetet dhe garancitë për zhvillimin e këtij programi. Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ka natyrë ndërdisiplinare, dhe fusha e studimit të tij përputhet me fushat e departamenteve në të cilat ai mbështetet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Sikurse është evidentuar edhe në Standardin 1.1, ky program studimi ka natyrë ndërdisiplinare, për këtë arsye, për realizimin e tij Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut që është përgjegjës për këtë program, bashkëpunon edhe me departamente të tjera të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si dhe me departamente të fakulteteve të tjera brenda UET. Konkretisht lëndët si Parimet e Kontabilitetit, Hyrje në Financë, etj, mbulohen nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës. Lëndët si Algoritmika dhe Hyrje në Programim, Arkitektura dhe Organizimi i Kompjuterit, Rrjetat Kompjuterike, etj, mbulohen nga Departamenti i Teknologjisë dhe Informatikës së Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB, Tabela 12). Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar si dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis këtyre departamenteve. Raportet vjetore të institucionit pasqyrojnë bashkëpunimin e tyre.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar, si dhe informacionin e marrë nga vizita në institucion, GVJ konstaton se UET ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucionet private dhe publike në vend, me qëllim realizimin e praktikave të studentëve, të trajnimeve, konsulencave, përmirësimit të kurrikulave, angazhimit të studentëve për realizimin e temave të diplomës apo të studimeve doktorale, me qëllim punësimin, etj. (Evidenca Nr. 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5)). Gjithashtu vlen për tu theksuar se UET ka dhe një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me universitete të huaja, në kuadër të partneritetit në projekte, të cilat janë një mbështetje për këtë institucion si për ngritjen e kapaciteteve edhe për shkëmbimin e studentëve dhe të stafit për trajnime dhe mësimdhënie. (Evidenca Nr. 34. Marrëveshjeve të Bashkëpunimit UET)
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Bazuar tek dokumentacioni, GVJ konstaton se UET ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me 16 institucione publike dhe private me qëllim realizimin e praktikave profesionale. Nga këto mund të përmendim shumë kompani në fushën e teknologjisë së informacionit si Info Business Solution, Smart Tech Solution, Smartwork, Infosoft, MikroTik Academy, INSTAT, të cilat lidhen drejtpërdrejt me fushën e studimit të programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" dhe ndihmojnë studentët për realizimin e praktikave dhe lidhjen me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



praktikave të punës apo stazhit etj.	tregun e punës. Gjithashtu lista e bashkëpunimit është e shtrirë edhe në biznese të fuqishme vendase dhe të huaja që operojnë në treg të tilla si Balfin, Lufthansa Industry, Lufthansa Industry Solution, Albtelecom, etj., të cilat mbështesin gjithashtu institucionin në realizimin e praktikave të studentëve, orëve të hapura të leksioneve me ekspertë të fushës, etj. (Evidenca Nr. 34.1.-34.14. Marrëveshjeve të Bashkëpunimit UET-institucione).			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, ka hartuar raporte periodike të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Sipas raportit të paraqitur në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit, për vitin 2024 Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit posedon rreth 57 marrëveshje bashkëpunimi ndërsa ka rreth 16 marrëveshje me subjekte dhe institucione bashkëpunuese respektivisht për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut i konsideron marrëveshjet si aleanca strategjike që mundësojnë realizimin e suksesshëm të operacioneve funksionale të tij. (Evidenca Nr. 35. Raport per Marreveshjet e Bashkepunimit.pdf).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis departamenteve në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si dhe me Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Për të përmbushur objektivat e planit mësimor ky program ka një shtrirje të lëndëve në disa departamente të këtyre fakulteteve.</i> <i>GVJ konstaton se UET ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucionet private dhe publike në vend, por gjithashtu ka krijuar një sërë partneritetesh të huaja, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e procesit mësimor në tërësi.</i> <i>GVJ konstaton se UET ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me 16 institucione publike dhe private me qëllim realizimin e praktikave profesionale, me kompani të njohura në fushën e teknologjisë së informacionit të cilat i shërbejnë specifiku këtij programi studimi.</i> <i>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, ka hartuar raporte periodike të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ofrohet me kohë të plotë, me një kohëzgjatje 3 vite akademike dhe 6 semestra, në përfundim të të cilit studenti fiton 181 kredite dhe pajiset me diplomë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe dhe angleze. (Evidenca Nr. 15. Model Diplome_Suplement Udhëzimi 11 - BSc Informatikë Ekonomike_shqip). Elementët që përbëjnë strukturën e këtij programi janë në përputhje me aktet ligjore (VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar) përsa i përket komponentëve mësimorë si dhe përqindjes së krediteve për secilin nga komponentët, përkatësisht: - Kategoria A: Lëndët Bazë kanë 20% të totalit të krediteve - Kategoria B: Lëndët Karakterizuese kanë 52% të totalit të krediteve - Kategoria C: Lëndët Ndërdisciplinore kanë 13% të totalit të krediteve - Kategoria D: Lëndët Plotësuese kanë 11% të totalit të krediteve - Kategoria E: Detyrimet Përmbyllëse kanë 4% të totalit të krediteve. <u>Bazur tek Urdhër Nr. 226, Datë 19.07.2021 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike”, në Universitetin Evropian të Tiranës, ky program është licënsuar me 180 kredite (ECTS), ndërkohë që sipas Planit Mësimor ky program ofrohet me 181</u>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<u>kredite (ECTS). Rekomandojmë që të rishikohet shpërndarja e krediteve në Planin Mësimor në mënyrë që në total numri i krediteve të jetë në përputhje me Urdhërin e hapjes së këtij programi.</u>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit, Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike), GVJ konstaton se tërësia e lëndëve në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofron një mbulim të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e biznesit dhe të teknologjisë së informacionit, duke ofruar larmi të përfitimit të njohurive përkatëse në këto fusha ndër të cilat mund të veçojmë formimin e aftësive profesionale në algoritmikë dhe programim, inxhinieri software-sh, zhvillim i web-it, rrjetat kompjuterike, bazat e të dhënave, big data dhe AI, ndërthurur me njohuri mbi kontabilitetin, financën, menaxhimin, marketingun, etj. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve (Evidenca Nr. 19. Syllabuset e programit), GVJ konstaton se në tërësi ky program mundëson dhënien e njohurive të kompletuara teorike dhe praktike në fushat e studimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit si dhe i mundëson studentëve punësim të mëtijshëm. Studentët që përfundojnë këtë program studimi kanë mundësi të punësohen si dizajnues të rrjetave kompjuterike, programues, specialist në institucionet bankare, të sigurimeve, financiare, specialist të marketingut dixhital, etj. Ndërthurja e lëndëve paraqitet në përgjithësi e kompletuar për të aftësuar studentët e programit të kuptojnë parimet akademike të të dyja disiplinave si dhe të përfshihen në analiza të rasteve komplekse studimore.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese janë të organizuara në 5 kategori, A-E, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar (Evidenca Nr. 14. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Informatikë Ekonomike (shqip&anglisht)). Në kategorinë A (36 ECTS) bëjnë pjesë lëndët bazë për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B (94 ECTS) janë lëndët karakterizuese të cilat mundësojnë një përgatitje shkencore; në kategorinë C (24 ECTS) përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D (20 ECTS) përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E (7 ECTS) janë detyrimet përmbyllëse për diplomim.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara	Sikurse është evidentuar edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi, bazuar tek plani mësimor, GVJ konstaton se




ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën dhe detyrimet përmbyllëse në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Përkatesisht praktika mbulohet nga lënda Praktikë dhe Zhvillim Karriere me 5 ECTS dhe detyrimet përmbyllëse shlyhen me Punimin e Diplomës ose Provimin Përfundimtar që ka 7 ECTS. (Evidenca Nr. 14. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Në bazë të dokumentacionit (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB, Tabela 18.1-18.2, Evidenca Nr. 50.2-50.6. Pasqyrat Financiare dhe Raport Auditimi) GVJ konstaton se forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve bëhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. UET si institucion jo publik që është, e bazon financimin kryesisht mbi të ardhurat nga tarifat e studimit por gjithashtu edhe nga përfitimi i granteve të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” i përket Fushës 6 Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, sipas vendimit të MAS mbi procesin e kodifikimit të këtij programi studimi (Evidenca Nr. 31.5. Njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit). Në bazë të lëndëve që përbëjnë kurrikulën e programit (Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit), GVJ konstaton se ai është hartuar dhe ofrohet në përputhje me VKM nr. 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua në takimin me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit se hartimi i kurrikulës është bazuar mbi programe të tjera të ngjashme si në IAL në vend edhe ato në univeritete të huaja.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” në gjuhën shqipe shoqërohet me kodin 63BA0688S dhe ai në gjuhën angleze me kodin 63BA0688A, të akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në përputhje me legjislacion në fuqi dhe fushën e studimit të këtij programi (Evidenca Nr. 31.5. Njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit). Gjithashtu nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi konstatohet që secila lëndë ka kodin e saj përkatës, i cili pasqyron tipologjinë dhe fushën ku ajo bën pjesë (fusha e ekonomisë apo ajo e informatikës dhe teknologjisë).

Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi nuk është një program i përbashkët midis UET dhe ndonjë IAL tjetër vendas ose të huaj.
Konkluzione	<i>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Përkatësisht kategoritë që përbëjnë këtë program studimit janë:</i> - <i>Kategoria A: Lëndët Bazë kanë 36 ECTS ose 20% të totalit të krediteve.</i> - <i>Kategoria B: Lëndët Karakterizuese kanë 94 ECTS ose 52% të totalit të krediteve.</i> - <i>Kategoria C: Lëndët Ndërdisciplinore kanë 24 ECTS ose 13% të totalit të krediteve.</i> - <i>Kategoria D: Lëndët Plotësuese kanë 20 ECTS ose 11% të totalit të krediteve.</i> - <i>Kategoria E: Detyrimet Përmbyllëse kanë 7 ECTS ose 4% të totalit të krediteve.</i> <u><i>Bazur tek Urdhër Nr. 226, Datë 19.07.2021 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike", në Universitetin Evropian të Tiranës, ky program është licencuar me 180 kredite (ECTS), ndërkohë që sipas Planit Mësimor ky program ofrohet me 181 kredite (ECTS). Rekomandojmë që të rishikohet shpërndarja e krediteve në Planin Mësimor në mënyrë që në total numri i krediteve të jetë në përputhje me Urdhërin e hapjes së këtij programi.</i></u> <i>Në tërësi ky program mundëson dhënien e njohurive të kompletuara teorike dhe praktike në fushat e studimit të biznesit dhe teknologjisë së informacionit si dhe i mundëson studentëve punësim të mëtejshëm. Studentët që përfundojnë këtë program studimi kanë mundësi të punësohen si dizajnues të rrjetave kompjuterike, programues, specialist në institucionet bankare, të sigurimeve, financiare, specialist të marketingut dixhital.</i> <i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" në gjuhën shqipe shoqërohet me kodin 63BA0688S dhe ai në gjuhën angleze me kodin 63BA0688A, të akorduar nga</i>



	<i>Ministria e Arsimit dhe Sportit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe fushën e studimit të këtij programi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në UET. Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të Ligjit të A.L. “<i>Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente</i>”, GVJ konfirmon se Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë: • Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut • Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës • Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit për tre vite akademike ka në përbërjen e tij (Evidenca Nr. 0.2 Tabelat përmbledhëse për aneks_RVB: Tabela 1.b: Të dhënat statistikore për stafin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit): <table><tr><th>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th></th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>6</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc. Dr</td><td>6</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr.</td><td>8</td><td>3</td></tr><tr><td>Dr. në proces</td><td>7</td><td>0</td></tr><tr><td>MSc</td><td>2</td><td>3</td></tr><tr><td>Total</td><td>29</td><td>9</td></tr></table> Referuar të dhënave në (Evidenca Nr. 0.2. Tabela 2.1/a, 2.2/a, 2.3/a: Aneks tabelat përmbledhëse, Të dhënat statistikore për stafin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut) si dhe pas konfirmimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili është edhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	2024-2025			PAE	PAK	Prof. Dr.	6	1	Prof. Asoc. Dr	6	2	Dr.	8	3	Dr. në proces	7	0	MSc	2	3	Total	29	9
Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	2024-2025																								
	PAE	PAK																							
Prof. Dr.	6	1																							
Prof. Asoc. Dr	6	2																							
Dr.	8	3																							
Dr. në proces	7	0																							
MSc	2	3																							
Total	29	9																							

të stafit (më specifikisht, duhet të ketë minimumi 7 pedagogë efektivë nga të cilët të paktën 3 me tituj/grada).

Bazuar tek Tabelat Përmbledhëse, të dhënat analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut në 3 vitet e fundit janë si më poshtë:

Departamenti Menaxhimit dhe Marketingu	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	0	2	0	1	0
Prof. Asoc. Dr.	0	1	1	3	1	2
Dr./PhD.	5	6	5	2	2	2
Dr. në proces	2	0	2	0	3	0
MSc	0	3	0	3	0	3
Total	8	10	10	8	7	7

Duke ju referuar tabelës së mësipërme mund të themi që departamenti përgjegjës për këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore për organizimin dhe strukturën. Megjithatë duke shqyrtuar të dhënat për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” (Evidenca Nr. 0.2 Tabela 2.1/a, 2.2/a/, 2.3/a2 : Të dhënat statistikore për stafin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, Tabela 4.a-b Ngarkesa totale BA Informatikë Ekonomike), GVJ konstaton se më shumë se 50% e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe më shumë se 50% e ngarkesës mësimore totale të programit mbulohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Një pjesë tjetër e stafit i përket departamenteve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e lëndëve të këtij programi mbulohet nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi. Për këtë arsye GVJ konkludon se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi duhet të rrisë numrin e stafit akademik dhe peshën e lëndëve që mbulon në këtë program, për të qenë në koherencë me nevojat e programit dhe përmbushjen e objektivave të tij, si dhe për të përmirësuar procesin mësimor në tërësi.

Përsa i përket procesit të akreditimit, sipas të dhënave në tabelat përmbledhëse (Evidenca Nr. 0.2 Tabela 3.b Të dhëna për programet që ofrohen në Fakultet), programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është licensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 226, datë 19.07.2021 dhe ky është akreditimi i parë.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit

Bazuar tek plani mësimor (Evidenca Nr. 14.2-3. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike), si dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion në takimin me

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	pedagogët dhe përgjegjësit e departamenteve të angazhuara në realizimin e këtij programi studimi, konstatojmë se praktikat mësimore zhvillohen në laboratorët e informatikës dhe mbulohen nga stafi akademik sipas lëndëve përkatëse. Institucioni gjithashtu ka angazhuar staf administrativ në ndihmë të zhvillimit të orëve të praktikave mësimore. Ky staf është pjesë e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe shërben gjithashtu për mirëmbajtjen e laboratoreve, përditësimin e programeve, instalimet e reja, etj.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut përgjegjës për këtë program studimi, ka zgjedhur një nga pedagogët efektivë si koordinatorin e këtij programi studimi. Koordinatori është caktuar me Vendim të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Nr. 40, datë 06.02.2024. Sipas akteve rregullatore të UET, detyrat e koordinatorit lidhen me ecurinë e zhvillimit të kurrikulës së programit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” si dhe me përditësimin e saj me të reja të shkencës dhe kërkesat e tregut të punës. Ai kontrollon syllabuset, përcakton materialet e nevojshme lëndore, bibliografinë, miraton detyrat e kursit, etj. <u>Megjithatë ajo që GVJ konstaton është që koordinatori i zgjedhur nuk është pjesë e stafit akademik mësimdhënës në këtë program studimi</u> (Evidenca Nr. 0.2 Tabelat Përmbledhëse: Tabela 4.a-b Ngarkesa Totale BA Informatikë Ekonomike, 6.1-6.3 Stafi akademik për programin e studimit BA Informatikë Ekonomike). <u>Për këtë arsye e shikon si të vështirë mundësinë e angazhimit të tij për përmbushjen sa më mirë të detyrave të caktuara dhe arritjen e objektivave të programit. GVJ rekomandon që koordinatori të jetë i lidhur ngushtësisht me këtë program studimi për të qenë më pranë përmbajtjes së programit dhe studentëve të tij.</u>
Konkluzione	<i>Nga ana e organizimit dhe strukturës GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili është edhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Megjithatë GVJ konstaton se më shumë se 50% e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe më shumë se 50% e ngarkesës mësimore totale të programit mbulohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Një pjesë tjetër e stafit i përket departamenteve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e lëndëve të këtij programi mbulohet nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi. Për këtë arsye GVJ konkludon se njësia bazë përgjegjëse për këtë</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<u>program studimi duhet të rrisë numrin e stafit akademik dhe peshën e lëndëve që mbulon në këtë program, për të qenë në koherencë me nevojat e programit dhe përmbushjen e objektivave të tij, si dhe për të përmirësuar e procesit mësimor në tërësi.</u> <i>Institucioni gjithashtu ka angazhuar staf administrativ në ndihmë të zhvillimit të orëve të praktikave mësimore. Ky staf është pjesë e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe shërben gjithashtu për mirëmbajtjen e laboratoreve, përditësimin e programeve, instalimet e reja, etj.</i> <i>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut përgjegjës për këtë program studimi, ka zgjedhur një nga pedagogët efektivë si koordinatorin e këtij programi studimi. Megjithatë ajo që GVJ konstaton është që koordinatori i zgjedhur nuk është pjesë e stafit akademik mësimdhënës në këtë program studimi. Për këtë arsye gjykon se e shikon të vështirë përmushjen e detyrave të koorindatorit. GVJ rekomandon që koordinatori të jetë i lidhur ngushtësisht me këtë program studimi për të qenë më pranë përmbajtjes së programit dhe studentëve të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ shqyrtoi informacionet publike të institucionit në faqen e tij të web-it (https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2025/04/Informatike-Ekonomike-BA.pdf) dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” disponohen dhe janë publike e të mundshme për t’u aksesuar lirisht nga studentët apo të interesuarit e tjerë. Gjithashtu bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se studentët kanë informacion në lidhje me programin e studimit pasi informohen që në fillim të studimeve, por edhe në fillim të çdo semestri nga pedagogët përkatës të lëndëve specifike. Gjithë informacionin në lidhje me programin e studimit ata e marrin gjithashtu nëpërmjet sistemit LMS (Evidenca Nr. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf). Nga takimi me përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut u informuam se i gjithë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	informacioni në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit gjenden të publikuara në folderin e përbashkët elektronik “Dokumentat UET” në të cilin kanë akses personeli akademik dhe administrativ sipas kompetencave dhe detyrave të tyre.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Përsa i përket këtij kriteri GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përmban planin mësimor të detajuar dhe atë të ndarë sipas veprimtarive formuese, të hartuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 (Evidenca Nr. 14.2-3. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike, Evidenca Nr. 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - BA Informatikë Ekonomike (shqip&anglisht).pdf). GVJ konfirmon se plani mësimor përmban ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të çdo lënde, sasinë e orëve të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, projekteve, praktikës dhe orët jashtë auditorit. Gjithashtu edhe kreditet për çdo lëndë dhe kategorinë ku ajo bën pjesë.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimeve të studentëve në këtë program studimi janë të paraqitura në Rregulloren Mësimore të programit, neni 2 si dhe në rregulloren e posaçme për politikën e pranimit (Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatikë Ekonomike”.pdf, Evidenca Nr.25.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf). Pranimi i studentëve në këtë program bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për kriterin e notës mesatare si dhe gjuhës angleze në nivelin B1 për studentët që do të pranohen në programin e studimit që ofrohet në gjuhën angleze. Në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve institucioni ka përcaktuar rregullat në nenin 9 të Rregullores si dhe në rregulloren e posaçme (Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatikë Ekonomike”.pdf, Evidenca Nr.26. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf). UET në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes i departamentit. GVJ shqyrtoi gjithashtu edhe Tabelat Përmbledhëse të RVB, Tabela 21 (Evidenca Nr 25. Cilesia ne Hyrje_Informatike



	Ekonomike_shqip&anglisht (BA)_Tabela 21) dhe konstaton për tre vitet e fundit specifikisht transferimet për: Bachelor në "Informatikë Ekonomike" - 2022-2023 numri i të transferuarve është 7 - 2023-2024 numri i të transferuarve është 4 - 2024-2025 numri i të transferuarve është 16 Bachelor në "Business Informatics" - 2022-2023 numri i të transferuarve është 1 - 2023-2024 numri i të transferuarve është 41 - 2024-2025 numri i të transferuarve është 0
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Referuar planit mësimor të programit të studimit (Evidenca Nr. 14.2-3. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike) si dhe syllabuseve të lëndëve (Evidenca Nr. 19. Syllabuset e lëndëve të BA Informatikë Ekonomike), GVJ konstaton se ato përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me praktikën në auditor, orët e seminarit, orët e laboratorit dhe orët e studimit individual. Të gjithë këta elementë janë në përputhje me udhëzimet e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar. Syllabuset përmbajnë edhe elementë të tjerë të tillë si: përmbledhjen e lëndës, metodologjinë e mësimdhënies, temat, formën e kontrollit të njohurive, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar, etj. GVJ konkludon se ky program studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore në përputhje me formatet e miratuara.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Mbështetur tek informacioni i marrë gjatë takimit në institucion me Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, si dhe pedagogët e lëndëve, GVJ konkludon se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" rishikohet çdo fillim viti akademik. Në këtë takim u informuam që përmirësimet e syllabuseve miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore. Këto ndryshime syjonjnë përshtatjen e programit me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit teknologjike. (Evidenca Nr. 37.1. Shembull_Raporti i vlerësimit të silabuseve_24-25.pdf)
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni disponon informacionet për strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", i vendos ato në dispozicion të studentëve, stafit dhe i bën ato publike, edhe në faqen e web-it. Plani mësimor përmban ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të çdo lënde, sasinë e orëve të leksioneve, seminarëve, ushtrimeve, projekteve, praktikës dhe orët jashtë auditorit. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit të studentëve si dhe të transferimit në këtë program studimi janë të paraqitura në Rregulloren Mësimore

	të programit dhe në rregullore të posaçme. Programet lëndore përmbajnë përmbledhjen e lëndës, metodologjinë e mësimdhënies, temat, formën e kontrollit të njohurive, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar, etj. Përmirësimet e syllabuseve bëhen çdo fillim viti akademik dhe miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Mbështetur tek Plani Mësimor i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, lëndët janë të shpërndara në 5 tipe veprimtarish (lëndë bazë; lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, diploma). (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike (shqip).pdf), Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit (shqip). Kjo gjë i jep mundësi studentëve të marrin njohuritë e nevojshme që nga ato bazë tek njohuritë më të thelluara, duke i përgatitur ata qoftë për tregun e punës qoftë për vazhdimin e studimeve në ciklin e 2-të. Sipas Rregullores së programit të studimit, në vitin e parë të studimeve zhvillohen lëndët e formimit bazë (të kategorisë A), lëndët plotësuese (të kategorisë D) dhe lëndët hyrëse të formimit karakterizues (të kategorisë B). Të gjitha lëndët në vitin e parë janë të detyrueshme. Gjatë vitit të dytë dhe të tretë të studimeve, studenti thellon njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit (kategoria B), si dhe plotëson interesat përmes lëndëve të profilit të zgjedhur prej tij (të kategorisë C). Ndër to spikasin lëndët Rrjetat Kompjuterike, Programim 1, Hyrje në Big Data dhe Inteligjencën e Biznesit, Web Development, Inxhinieri Softwerike, Kontabiliteti Financiar, Sistemet e Informacionit në Menaxhim, etj, të cilat do ti aftësojnë studentët në zhvillimin e aplikacioneve dhe implementimin e tyre në organizata (Evidenca Nr. 19. Syllabuset e lëndëve të BA Informatikë Ekonomike). Mbështetur nga sa më sipër GVJ konstaton se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundëson thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve si për tu punësuar sipas

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	nevojave të tregut në këtë fushë si për studime në nivelin master.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se në Rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë objektivat formuese të programit dhe rezultatet e të nxënit që synohet të kenë studentët nga ky program (Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”.pdf). Sipas Rregullores programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” synon: • Të pajisë studentët me njohuri dhe koncepte bazë formuese në fushën e studimit informatikë ekonomike. • Aftësojë studentët nga këndvështrimi teorik dhe praktik si specialistë të informatikës së aplikuar në biznes. • Aftësojë studentët me njohuritë bazë formuese në fushën e bazës së të dhënave, gjuhët e programimit, rrjetat kompjuterike, etj. • Të përgatisë studentët me njohuri të rinovuara që ofron literatura në fushën e informatikës ekonomike. • T’u ofrojë studentëve aftësi profesionale të mjaftueshme për realizimin e studimeve të kësaj fushe në nivele më të larta. Këto objektiva përmbushen duke marrë në konsideratë shpërndarjen e lëndëve sipas kategorive formuese, dhe gjithashtu shpërndarjen sipas viteve akademike (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike (shqip).pdf). Siç e cilësuam edhe në kriterin 1 të këtij standardi, viti i parë i studime fillon me lëndët bazë, plotësuese dhe disa karakterizuese dhe më pas vazhdohet në vitin e dytë dhe të tretë me lëndët e profilit. Kjo ndarje shërben për plotësimin e objektivave formueset dhe përvetësimin e rezultateve të të nxënit.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ pasi shqyrtoi Planin Mësimor si dhe programet e lëndëve të ofruara në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, konfirmon se këto lëndë ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi i tyre paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, si dhe me programe studimi në vend në të njëjtën fushë.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave	Përsa i përket strukturës së programit, peshën më të madhe e zënë lëndët karakterizuese (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për anakes_RVB Plani mësimor sipas kategorive Tabela 9.pdf): - Kategoria A: Lëndët Bazë kanë 20% të totalit të krediteve

formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	- Kategoria B: Lëndët Karakterizuese kanë 52% të totalit të krediteve - Kategoria C: Lëndët Ndërdisciplinore kanë 13% të totalit të krediteve - Kategoria D: Lëndët Plotësuese kanë 11% të totalit të krediteve - Kategoria E: Detyrimet Përmbyllëse kanë 4% të totalit të krediteve. Këto lëndë me njohuritë që ofrojnë e përgatisin studentin për tregun e punës në këto specialitete (Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”.pdf): - Specialist IT, dizenjues i rrjetave kompjuterike - Specialist IT, programist - Specialist për proceset e biznesit - Personel IT, specialist në sektorin bankar - Personel IT, specialist në sektorin e sigurimeve - Personel IT, specialist në institucione financiare - Specialist marketingu në mjedisin dixhital - Specialist për statistikën bankare - Specialist i teknologjisë së informacionit Në tabelën 13 të Tabelave Përmbledhëse (Evidenca Nr. 0.2. Forma e mësimdhënies në programin e studimit Tabela 13.pdf) gjendet informacion në shkallë të përmbledhur në lidhje me ngarkesën totale të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Nga kjo tabelë shohim elementet e mëposhtme të ngarkesës totale: <table border="0"> <tr> <td>- Leksione / Seminare</td><td>658 orë</td></tr> <tr> <td>- Seminare</td><td>437 orë</td></tr> <tr> <td>- Ushtrime / Laboratore</td><td>208.8 orë</td></tr> <tr> <td>- Praktika në auditor</td><td>417 orë</td></tr> <tr> <td>- Praktikë profesionale</td><td>100 orë</td></tr> <tr> <td>- Diploma / Provim Formimi</td><td>20 orë</td></tr> <tr> <td>Totali</td><td>1840.8 orë</td></tr> </table> Raporti Teori (leksione+seminare) / Praktikë (laboratore + praktika në auditor + praktika profesionale + diploma) rezulton 1095 orë teori / 745.8 orë praktikë, ose afërsisht 60% / 40%. GVJ vlerëson pozitivisht peshën e konsiderueshme të orëve të praktikës ku përfshihen laboratore dhe praktika.	- Leksione / Seminare	658 orë	- Seminare	437 orë	- Ushtrime / Laboratore	208.8 orë	- Praktika në auditor	417 orë	- Praktikë profesionale	100 orë	- Diploma / Provim Formimi	20 orë	Totali	1840.8 orë
- Leksione / Seminare	658 orë														
- Seminare	437 orë														
- Ushtrime / Laboratore	208.8 orë														
- Praktika në auditor	417 orë														
- Praktikë profesionale	100 orë														
- Diploma / Provim Formimi	20 orë														
Totali	1840.8 orë														
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e	Mbështetur tek informacioni i marrë në institucion me Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, GVJ konkludon se ka një praktikë të rishikimit të syllabuseve të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” çdo fillim viti akademik. (Evidenca Nr. 37.1. Shembull_Raporti i vlerësimit të silabuseve_24-25.pdf). Ato vlerësohen në lidhje me përmbajtjen, metodologjinë e														



tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	mësimdhënies, rezultatet e të nxënit, kontrollin e njohurive, literaturën, etj. Të gjithë këta elementë synojnë në ofrimin e kompetencave të nevojshme në përputhje me kërkesat e tregut. Sipas dokumentit (Evidenca Nr. 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.pdf) literatura bazë duhet të jetë publikim i shtëpive prestigjioze botuese ndërkombëtare (Oxford University Press, Cambridge University Press, etj) dhe duhet të jetë e 5 viteve të fundit. Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se në përgjithësi kjo kërkesë respektohet por vërejmë se në disa raste u ndeshën edhe tekste të para 10 apo 15 viteve të fundit, të cilat përdoren si literaturë e detyruar. <u>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës për ato lëndë që nuk e kanë.</u>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në shqyrtimin e tërësisë së syllabuseve për të tre vitet, GVJ arrin në përfundimin se në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket lëndëve, kombinimit të tyre mes kategorive formuese si edhe raporti teori/praktikë mundëson përfitim e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teorike dhe praktike të synuara për një program të ciklit të parë. (Evidenca Nr. 19. Syllabuset e lëndëve të BA Informatikë Ekonomike).
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Duke u mbështetur tek sa u tha në kriteret më sipër për vlerësimin e syllabuseve, GVJ konstaton se në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” mundëson si vijimin e mëtejshëm të studimeve (këtë e tregojnë edhe mobilitetet e studentëve) (Evidenca Nr. 26. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf) ashtu edhe punësimin e menjëhershëm të studentëve në tregun e punës. (Evidenca Nr. 29. Monitorimi i ecursisë së studentëve diplomimit dhe punësimit të tyre - Informatikë Ekonomike.pdf).
Konkluzione	GVJ konstaton se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundëson thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve si për tu punësuar sipas nevojave të tregut në këtë fushë si për studime në nivelin master. Në këtë program studimi janë përcaktuar qartë objektivat formuese dhe rezultatet e të nxënit që synohet të kenë studentët në përfundim të studimeve. GVJ vlerëson pozitivisht peshën e konsiderueshme të orëve të praktikës ku përfshihen laboratore dhe praktika. GVJ konkludon se ka një praktikë të rishikimit të syllabuseve të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” çdo fillim viti akademik. GVJ konstaton se në përgjithësi kjo kërkesë respektohet por vërejmë se në disa raste u ndeshën edhe tekste të para 10 apo 15 viteve të fundit, të cilat përdoren si literaturë e detyruar. <u>GVJ rekomandon përditësimin e</u>

	<i>literaturës për ato lëndë që nuk e kanë. Në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket lëndëve, kombinimit të tyre mes kategorive formuese si edhe raporti teori / praktikë mundëson përfundimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teorike dhe praktike të synuara për një program të ciklit të parë, si dhe mundëson punësimin e studentëve në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Bazuar në evidencat dhe dokumentacionin e shqyrtuar programi është hapur me Urdhër Nr. 226, Datë 19.07.2021 të MASR dhe që nga hapja nuk ka pasur ndryshime përgjatë këtyre 4 viteve akademike të ofrimit të tij. GVJ konstaton se argumenti për hapjen e këtij programi studimi është bazuar mbi studimin e tregut si dhe takimet me Bordin e Tregut të Punës dhe ka evidentuar nevojën për profesionistë në këtë fushë. (Evidenca Nr. 17. Studimi për tregun e punës.pdf, Evidenca Nr. 12.1. Bordin e tregut të punës.pdf, Evidenca Nr. 12.2. Agjenda e takimit me Bordin e Tregut të Punës.pdf). Sikurse u evidentua në Standardin II.3, përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” rishikohet çdo fillim viti akademik. Përmirësimi i syllabuseve synon përshtatjen e programit me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit teknologjike, ndryshime të cilat miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore. Në takimin me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, GVJ u informua që hartimi dhe përmirësimi i programeve të studimit mbështetet në një proces të vazhdueshëm konsultimi me partnerët e biznesit por edhe me studentët e diplomuar, për të siguruar që programet që ofrohen përfshijnë të gjithë kompetencat e nevojshme që nevojiten në tregun e punës. (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf, Evidenca Nr. 12.4. Mbledhje e hapur me studentet.pdf).
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime	GVJ konstaton se UET ka zyrtarizuar përfshirjen e studentëve të diplomuar në procesin e përmirësimit të programeve të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	studimit që ai ofron. Konkretisht kjo gjë përcaktohet në Planin Strategjik UET 2021-2025, si dhe në Statutin e universitetit. (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf, Evidenca Nr. 2. Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale.pdf). Gjithashtu në takimin me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut GJVJ u informua që shoqata "UET ALUMNI" e krijuar që në Maj të vitit 2010, ka një kontribut shumë të madh në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit, ata janë lobistët më të mëdhenj të universitetit, janë mbledhësit e fondeve, aplikuesit për projekte, ata gjenerojnë ide për programe të reja, krijojnë tregjet e punës për universitetin, etj. Gjithashtu ata vlerësuan shumë funksionimi prej 10 vitesh të Bordeve të Tregut të Punës. Bordet janë të atashuara pranë çdo departamenti dhe përbëhen nga së paku 10 anëtarë, të cilët janë ish-studentët e UET. Bordet e tregut të punës janë një pikë kontakti për punësimin, praktikat profesionale dhe internshipet. (Evidenca Nr. 3. https://uet.edu.al/uet-alumni).			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Sikurse e cilësuam edhe në kriterin 1 dhe 2 të këtij standardi, institucioni është mbështetur në studimin e tregut dhe analizën e nevojave për profesionistë të kësaj fushe për hapjen e këtij programi. Aktualisht ky program nuk ka pësuar ndryshime në përmbajtje që nga hapja, meqësnëse ka vetëm 4 vite akademike që është hapur. Megjithatë në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, GJVJ u informua që një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen e programit me nevojat aktuale të tregut luan Bordi i Tregut të Punës, i cili luan një rol aktiv duke marrë pjesë sa herë institucioni organizon diskutime, tryeza të rrubullakta, leksione të hapura me ekspertët e fushës, etj. (Evidenca Nr. 17. Studimi për tregun e punës.pdf, Evidenca Nr. 12.1. Bordi i tregut të punës.pdf, Evidenca Nr. 12.2. Axxhenda e takimit me Bordin e Tregut të Punës.pdf).			
Konkluzione	<i>Institucioni është mbështetur në studimin e tregut dhe analizën e nevojave për profesionistë të kësaj fushe për hapjen e këtij programi studimi. GJVJ konstaton që një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen e programit me nevojat aktuale të tregut luan Bordi i Tregut të Punës. GJVJ konstaton që shoqata "UET ALUMNI" gjithashtu ka një kontribut shumë të madh në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit, ata gjenerojnë ide për programe të reja, krijojnë tregjet e punës për universitetin, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar tek Tabela 13 në tabelat përmbledhëse të RVB (Evidenca Nr. 0.2. Forma e mësimdhënies në programin e studimit Tabela 13.pdf) si dhe në analizën e syllabuseve, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet, seminarët, orët e laboratorit ose të ushtrimeve, detyrat e kursit ose orët e praktikës. Gjithashtu vëmë re se sipas specifikave të lëndëve, ka dhe forma të tjera të mësimdhënies dhe mësimnxënies të tilla si rastet studimore individuale dhe në grup, ndërtimi i aplikacioneve të thjeshta, etj. GVJ u informua nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar që departamenti përgjegjës për këtë program studimi ka zhvilluar orë mësimi të hapura në bashkëpunim me ekspertë të fushës së menaxhimit apo IT.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personelin akademik dhe me studentët, GVJ konstatoi se personeli akademik përdor larmishmëri të metodave të mësimdhënies, duke kombinuar shpjegimin me metodën tradicionale me analizimin apo aplikimin e raste praktike gjatë orëve mësimore dhe gjatë laboratorëve si dhe të trajtimin e situatave sa më aktuale në fushën e informatikës ekonomike. Gjatë mësimin në auditor përdoren gjerësisht mjetet e teknologjisë si kompjuterat, projektorët, tabela interaktive, etj, për t'ju përshtatur nevojave të studentëve. Po kështu edhe studentët u shprehën në përgjithësi konfidentë në lidhje me metodat e mësimdhënies që përdorehin me ta dhe konfirmuan që alternimi i leksioneve me laboratorët dhe rastet praktike i ndihmonte gjatë studimeve të tyre.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar (Evidenca Nr. 33. Të dhëna për aktivitete dhe trajnime për stafin dhe studentet.pdf, Evidenca Nr. 3.5. Dokumenti SCL Teaching and Assessment Policy.pdf, Evidenca Nr. 3.6. Vendimi nr 9, date 06.07.2023 Per miratimin e dokumentit SCL Teaching and Assessment Policy.pdf) si dhe tek diskutimet me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UNYT mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike, duke i përfshirë në trajnime që i aftësojnë ata në fushën akademike. Gjithashtu GVJ u informua që UET organizon në mënyrë periodike aktivitetin “Dita e Zhvillimit të Stafit”, që ka si qëllim trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Në fillim të vitit akademik organizohet edhe trajnimi “Back to Work”. Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni mbështet stafin akademik për pjesëmarrjen në programet Erasmus+ të mobilitetit për mësimdhënie në universitetet ndërkombëtare si një mundësi për të përfituar nga përvojat më të mira të mësimdhënies. (Evidenca Nr. 28. Projekte aktive dhe aplikime_Lista e partnerëve ndërkombëtarë.pdf, (Evidenca Nr. 28.4. Lista e projekteve_stafi nga Departamenti i përfshirë në to.pdf, Evidenca Nr. 28.5. Mobilitetet_staf_studentë.pdf, Evidenca Nr. 28.6. Extract RV 2021-2022_Mobilitete IAL.pdf, Evidenca Nr. 28.7. Extract RV 2022-2023_Mobilitete IAL.pdf, Evidenca Nr. 28.8. Extract RV 2023-2024_Mobilitete IAL.pdf).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e	Mbështetur tek shqyrtimi i dokumentacionit (CV-të e stafit akademik Evidenca Nr. 20. CV e stafit akademik të programit të studimit.pdf) GVJ konstaton që kompetenca e personelit konfirmohet nëpërmjet kualifikimeve dhe ekspertizës së tyre. Gjithashtu në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, u informuam që kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi dhe rekrutimi i stafit, janë treguesit e performancës të tilla si përvoja në mësimdhënie, niveli universitar, karriera profesionale jashtë auditori, kualifikimet, titujt e gradat shkencore, përputhja e formimit dhe interesave kërkimore të çdo pedagogu me lëndën që ai jep, etj. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se ata ishin të kënaqur me performancën e stafit akademik, duke theksuar mbështetjen e stafit në çdo aspekt që lidhej me procesin mësimor.



marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	GVJ konstaton se institucioni i ka dhënë rëndësi të veçantë përfshirjes së studentëve në vlerësimin e mësimdhënies dhe përmirësimit të metodave të përdorura. Studentët janë të përfshirë në mbledhje periodike mujore, të cilat realizohen me qëllim dëgjimin e mendimeve, sugjerimeve dhe ankesave të tyre në lidhje me elementë të ndryshëm të programit të tyre të studimit. (Evidenca Nr. 6.2. Shembull_Procesverbal mbledhje departamenti_mbledhje e hapur departamenti me studentë.pdf, Evidenca Nr. 12.4. Mbledhje e hapur me studentet.pdf). Gjithashtu studentët japin mendimin e tyre individual edhe nëpërmjet pyetësorëve që shpërndahen në fund të çdo semestri për vlerësimin e përmbajtjes së lëndëve, metodave të mësimdhënies dhe performancës së pedagogëve.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Struktura kryesore në nivel institucional është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e cila propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati i UET. Kjo strukturë vlerëson në mënyrë periodike veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësimin e tyre. Në takimin me përfaqësuesit e kësaj zyre GVJ u informua se kjo zyrë bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet e UET, realizon aktivitetet e parashikuara në planin e vet të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf, Evidenca Nr. 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC.pdf, Evidenca Nr. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf, Evidenca Nr. 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf, Evidenca Nr. 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf, Evidenca Nr. 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakti i fokus grupeve.pdf). GVJ u informua që KSBC është një strukturë mbështetëse për personelin akademik, duke siguruar që aktiviteti i saj është në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe rritjes së performancës së stafit. Në këtë aspekt shërbejnë edhe trajnimet e stafit të evidentuara në kriterin 3 të këtij standardi.
Konkluzione	GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet, seminarët, orët e laboratorit/të ushtrimeve, detyrat e kursit / orët e praktikës. GVJ konstatoi se personeli akademik përdor larmishmëri të metodave të mësimdhënies, duke kombinuar shpjegimin me metodën tradicionale me analizimin apo aplikimin e raste praktike gjatë

	orëve mësimore dhe gjatë laboratorëve si dhe trajtimin e situatave sa më aktuale në fushën e informatikës ekonomike. Institucioni mbështet stafin akademik për pjesëmarrjen në programet Erasmus+ të mobilitetit për mësimdhënie në universitetet ndërkombëtare si një mundësi për të përfituar nga përvojat më të mira të mësimdhënies. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se ata ishin të kënaqur me performancën e stafit akademik, duke theksuar mbështetjen e stafit në çdo aspekt që lidhet me procesin mësimor. Studentët janë të përfshirë në mbledhje periodike mujore, të cilat realizohen me qëllim dëgjimin e mendimeve, sugjerimeve dhe ankesave të tyre në lidhje me elementë të ndryshëm të programit të tyre të studimit. Struktura kryesore në nivel institucional është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo strukturë vlerëson në mënyrë periodike veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mbështetur tek Rregullorja e UET neni 16 (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET.pdf), GVJ konstaton se bazuar në mënyrën e organizimit të mësimit dhe formës së kontrollit të dijeve, lëndët ndahen në 2 tipologji: - Lëndë të Tipologjisë I konsiderohen lëndët me karakter kryesisht praktik/aplikativ. - Lëndë të Tipologjisë II konsiderohen lëndët me karakter kryesisht teorik. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm (Rregullorja e UET neni 24): Për lëndët e Tipologjisë I - Provimit përfundimtar (40%) - Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%) Për lëndët e Tipologjisë II - Provimit përfundimtar (40%) - Provimit të ndërmjetëm (30%) - Detyrës së kursit (20%) - Nivelit të diskutimit në seminare (10%).




	Të njëjtat informacione janë edhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” (pika 3.14 dhe 5.2) (Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”.pdf). Gjatë takimit me studentët, GVJ u informua se studentët janë të njohur me mënyrën e vlerësimit të njohurive të tyre, në fillim të çdo semestri nga pedagogët përkatës por edhe nga dokumentat që ju shpërndahen në sistemin LMS.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sikurse e evidentuam edhe në kriterin 1 të këtij standardi, bazuar tek informacioni i marrë në takimin me studentët dhe pedagogët e programit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, GVJ e konfirmon se në fillim të semestrit, për çdo lëndë pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabusin e lëndës duke shpjeguar të gjithë elementët përbërës të tij, përfshirë edhe mënyrën e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, kriteret e vlerësimit, detyrimet për pjesëmarrjen, etj. Syllabusi ju shpërndahet studentëve në rrugë elektronike që në javën e parë të mësimi, nëpërmjet sistemit LMS ose MsTeams. (Evidenca Nr.46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf, Evidenca Nr.46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS-LMS.pdf)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sikurse u evidentua në kriterin 1, në varësi të tipologjisë së lëndës përdoren metoda të ndryshme për vlerësimin e njohurive të studentëve. Në këtë mënyrë studenti ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat që ka fituar. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata ishin të kënaqur me këtë shpërndarje të peshës së vlerësimit nëpërmjet detyrave praktike, detyrave të kursit, diskutimeve në seminare, provimit të ndërmjetëm apo provimit përfundimtar.
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konstaton se në mbështetje të Rregullores së UET neni 22 (vlerësimi i procesit mësimor), Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut realizon këto aktivitete në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor: në mënyrë periodike në fund të çdo semestri shpërndahet pyetësori i studentëve, gjithashtu departamenti realizon fokus grupet me studentët si dhe mbledhjet e hapura ku përmes opinioneve e mendimeve të tyre ndërmerren masa për përmirësimin e procesit mësimor në të gjitha aspektet që konstatohet si e nevojshme. (Evidenca Nr. 6.2. Shembull_Procesverbal mbledhje departamenti_mbledhje e hapur departamenti me studentë.pdf, Evidenca Nr. 12.4. Mbledhje e hapur me studentet.pdf).
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të	Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se sipas tipologjisë së lëndëve ato ofrojnë metoda të ndryshme të përcimit të dijeve, si dhe të nivelit të angazhimit aktiv të studentëve gjatë procesit

shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	mësimor. Kjo pasqyrohet tek format e vlerësimit, ku një peshtë të konsiderueshme zënë edhe detyrat e kursit, detyrat praktike, apo pjesëmarrja aktive në seminare. Bazuar në pyetjet drejtuar studentëve, GVJ konstaton se një ndër format e parapëlqyera të studentëve ishte aplikimi i njohurive të marra në laborator dhe zhvillimi i aplikacioneve kompjuterike nga vetë ata. GVJ mendon se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon pavarësinë e studentit, si dhe i bën ata më të hapur dhe të aftë për nevojat e tregut.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Rregullorja e UET dhe Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përmbajnë qartësisht kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. GVJ konfirmon se në fillim të semestrit, për çdo lëndë pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabusin e lëndës duke shpjeguar të gjithë elementët përbërës të tij, përfshirë edhe mënyrën e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, kriteret e vlerësimit, detyrimet për pjesëmarrjen, etj. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut realizon aktivitete në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor të tilla si shpërndarja e pyetsorit të studentëve, realizimi i fokus grupeve me studentët si dhe mbledhjet e hapura ku përmes opionioneve e mendimeve të tyre ndërmeren masa për përmirësimin e procesit mësimor në të gjitha aspektet që konstatohet e nevojshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet	Sikurse u evidentua edhe në standardin 3.2, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit janë të përcaktuara në Rregulloren e UET, Rregulloren e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafan", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, si dhe në syllabuset e çdo lënde, të hartuara nga titullari i lëndës. Studentët janë të njohur me këtë menyrë kontrolli dhe vlerësimi që në fillim të semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm: Për lëndët e Tipologjisë I a. Provimit përfundimtar (40%) b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%) Për lëndët e Tipologjisë II a. Provimit përfundimtar (40%) b. Provimit të ndërmjetëm (30%) c. Detyrës së kursit (20%) d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%). (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET.pdf, Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”.pdf, Evidenca Nr. 19. Syllabuset e lëndëve të BA Informatikë Ekonomike).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Gjatë takimit me pedagogët dhe studentët, GVJ u informua që në përgjithësi provimet bëhen me shkrim. Megjithatë në varësi të tipologjisë së lëndës testet hartohen të tilla që korrigjimi i tyre të bëhet me platforma elektronike. GVJ u informua që UET bashkëpunon me AADF që prej vitit akademik 2016-2017, e cila i mundëson sistemin elektronik të vlerësimit “Clean Scoring”. Nëpërmjet këtij sistemi korrigjimi është më i shpejtë dhe shmangen gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë korrigjimit të testeve me dorë. Në këtë mënyrë synohet të shmangët abuzimi dhe subjektivizmi.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” janë hartuar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Syllabuset e të gjitha lëndëve të këtij programi përmbajnë komponentë përbërës të kontrollin të vazhdueshëm, rezultati e të cilave jep vlerësimin përfundimtar. Në takimin me studentët, GVJ konfirmoi që vlerësimi përfundimtar i çdo lënde ishte bërë në përputhje me syllabusin përkatës.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të	GVJ u informua në takimin me studentët që nëse ata kishin pyetje apo paqartësi në lidhje me korrigjimin dhe vlerësimin e testeve, pedagogët ishin të hapur për komente dhe feedback ndaj tyre. Ata u shprehën se stafi akademik ju mundësonte ballafaqimin e vlerësimeve dhe bënte takime me studentët, pas shpalljes së notave, ku studentët kanë të drejtën të shohin provimet e tyre. Ata u shprehën se në çdo rast, merrnin argumenta për pikët e marra nga ana e pedagogëve, si dhe këshilla për pikat ku kishin nevojë të përmirësoheshin.



përmirësohet në të ardhmen.	
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulla të cilat synojnë shmangien e kopjimit si në detyrat gjatë vitit dhe në provime duke përcaktuar edhe saksionet në rastet e shkeljes së etikës nga çdo student. Studenti njihet me këto rregulla dhe sanksione ndëpërmjet Broshurës së Dokumenteve të institucionit të cilat i merr që në fillim të studimeve (<i>Kodi i Etikës pika 10, Rregullore e UET neni 33</i>), dhe gjithashtu çdo syllabus përmban në fund rregullat dhe sanksionet për ndalimin e çdo forme kopjimi apo plagjiature. (<i>Evidenca Nr.16. A.II. Kodi i Etikës.pdf, Evidenca Nr. 5. Rregullore UET.pdf</i>).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ u informua gjatë vizitës në institucion se sipas Rregullores së UET, pedagogët dorëzojnë vlerësimet e bëra gjatë semestrit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, në këtë mënyrë shmanget çdo mundësi e ndryshimit të tyre nga pedagogët pas daljes së rezultateve të provimeve përfundimtar, duke synuar të bëhet një vlerësim i drejtë për studentët dhe sipas meritës së tyre. Provimet zhvillohen të sekretuara dhe pedagogët vlerësojnë mbi bazën e meritës dhe jo të emrit të studentit. Nota e studentit është rezultante e të gjithë komponentëve të vlerësimit të cilët janë në çdo hap të deklaruar dhe të njohur nga studentët dhe sekretaria mësimore gjithashtu.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në bazë të Rregullores së UET neni 32 si dhe Rregullores së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", GVJ konstaton se institucioni garanton të drejtën e studentit për t'u njohur me vlerësimin si dhe i jep mundësinë për rishikimin e tij. GVJ u informua në takimin me përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut se në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka marrë shpjegimet përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, për rivlerësimin e komponentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Në takimin me studentët GVJ u informua që ka pasur raste nga ana e tyre me kërkesat për rishikimin e rezultateve të provimit, por që ishin sqaruar pa pasur nevojë për të ngritur komision të rivlerësimit.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	
Konkluzione	<i>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Studentët janë të njohur me këtë mënyrë kontrolli dhe vlerësimi që në fillim të semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa</i>

	aktiviteteve të realizuara gjatë semestrit. Në përgjithësi provimet bëhen me shkrim dhe në varësi të tipologjisë së lëndës dhe formatit të testit ato korrigjohen me sistemin elektronik "Clean Scoring". GVJ konstaton se stafi akademik ju mundëson studentëve ballafaqimin e vlerësimeve dhe bën takime me ta pas shpalljes së notave, ku studentët kanë të drejtën të shohin provimet e tyre. Institucioni ka hartuar rregulla të cilat synojnë shmangien e kopjimit si në detyrat gjatë vitit dhe në provime duke përcaktuar edhe saksionet në rastet e shkelejs së etikës nga çdo student.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Sipas Planit Strategjik për zhvillimin e programit të studimit (Evidenca Nr.4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit.pdf), objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është t'u japë studentëve njohuritë bazë formuese në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj., me objektiv kryesor formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon studime në fusha të informatikës të tilla si: gjuhët e programimit, arkitektura e kompjuterave, sistemet e operimit, algoritmikë, strukturë të dhënash, web development, etj., të kombinuara me njohuritë të tjera specifike të fushës së ekonomisë si statistikë në dy nivele, matematikë e zbatuar në ekonomi, menaxhim, marketing dhe financë. Mbështetur tek ky kombinim lëndësh si dhe kombinimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies, programi garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale për studentët.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane,	Ky program studimi është i lidhur ngushtësisht me teknologjinë e informacionit për vetë fushën e studimit ku ai mbështetet. Në bazë të Rregullores së programit, në përfundim të studimeve studentët do të jenë të aftë: - Të demonstrojnë njohuri shumë të mira në aspektet teorike, dhe në aftësitë praktike të zbatueshme në fushat

sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	e shërbimeve elektronike, organizimit të sistemeve kompjuterike, web design, inxhinierisë softuerike, etj. - Të mundësojnë zbatimin e informatikës në zgjidhjen e problemeve ekonomike, planifikimit dhe administrimit të suksesshëm të biznesit. - Të njohin funksionimin e rrjetave kompjuterike, të kenë njohuri në ndërtimin e aplikacioneve duke përdorur gjuhë programimi të avancuara. Bazuar nga sa më sipër, GVJ konkludon se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar tek dokumentet e shqyrtuara (Evidenca Nr.19.1 Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf) një nga rubrikat e përfshira në syllabuset e lëndëve është “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit” ku paraqiten njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të përvetësojë në përfundim të lëndës. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të këtij programi e kanë këtë rubrikë. Nga diskutimi me studentët dhe pedagogët, GVJ u informua se në përfundim të lëndës bëhet një përmbledhje e lëndës ku diskutohen rezultatet e të nxënit dhe analizohet shkalla e arritjes së tyre.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me	Nga shqyrtimi i planit mësimor (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike (shqip).pdf) të programit të studimit vëmë re që të gjitha lëndët zhvillojnë orë praktike profesionale në auditor dhe jashtë auditori. Nëpërmjet këtyre orëve studentët aplikojnë njohuritë e marra në leksione dhe seminare dhe zhvillojnë kompetencat që çdo lëndë synon. Gjithashtu programi parashikon edhe Praktikën Profesionale si lëndë të veçantë të detyrueshme, që zhvillohet në semestrin e 2-të të vitit të 3-të. Kjo ju mundëson studentëve të arrijnë të zhvillojnë dhe aplikojnë në këtë lëndë njohuritë e marra në lëndët e ndryshme. Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe planit mësimor, evidentohet që metodat e mësimdhënies të përdorura nga personeli akademik janë të kombinuara, duke synuar sa më shumë përfshirjen e studentëve në diskutime dhe punë në grup. Vetë studentët shpreheshin të kënaqur me përdorimin e këtyre metodave duke i konsideruar më motivuese dhe më produktive për të zhvilluar idetë e tyre inovative. Përsa i përket bashkëpunimit me institucione të tjera ndërkombëtare në kuadër të mobilitetit të studentëve, evidentohet se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe




institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	inkurajon studentët për mobilitete në universitete të huaja. GVJ konstaton se partneriteti me universitetet evropiane është një pikë e fortë e këtij institucioni. (Evidenca Nr.28.5 Mobilitetet staf studentë.pdf)			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka hartuar një kalendar aktiviteteve ku ka parashikuar orë të hapura dhe seminare me të ftuar të ndryshëm, ekspertë të fushës. Gjithashtu nëpërmjet këtyre aktiviteteve organizohen edhe trajnime. Gjatë takimit me studentët e këtij programi, ata konfirmua ndjekjen e këtyre aktiviteteve dhe u shprehën që ato ishin shumë informuese. (Evidenca Nr. 56. Kalendar i aktiviteteve 2023-2024_Extract RV 23-24.pdf, Evidenca Nr. 56.1. Aktivitetet e Departamentit të Menaxhim dhe Marketing 2021-2023.pdf).			
Konkluzione	GVJ konstaton se kurrikula e programit është hartuar e tillë që garanton thellimin e njohurive në fushën e informatikës dhe të biznesit. Ajo mundëson përfitimin e njohurive shumë të mira si në aspektin teorik dhe praktik të zbatueshme në fushat e shërbimeve elektronike, organizimit të sistemeve kompjuterike, web design, inxhinierisë softuerike, etj. GVJ konstaton se në përfundim të lëndës bëhet një përmbledhje ku diskutohen rezultatet e të nxënës dhe analizohet shkalla e arritjes së tyre. Të gjitha lëndët zhvillojnë orë praktike profesionale në auditor dhe jashtë auditori. Nëpërmjet këtyre orëve studentët aplikojnë njohuritë e marra në leksione dhe seminare dhe zhvillojnë kompetencat që çdo lëndë synon. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe inkurajon studentët për mobilitete në universitete të huaja. GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka hartuar një kalendar aktiviteteve ku ka parashikuar orë të hapura dhe seminare me të ftuar të ndryshëm, ekspertë të fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbysëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------



Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në bazë të dokumentave të shqyrtuara GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një rregullore të posaçme për diplomimin (Evidenca Nr. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf) në të cilën janë të paraqitura në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet që lidhen me procesin e diplomimit për të gjitha nivelet e programeve të studimit, që nga zgjedhja e temës, udhëheqësi, seancat metodologjike, struktura e punimit, procedurat e mbrojtjes, etj. Gjithashtu rregullat e diplomimit janë të përshkruara edhe në Rregulloren e UET neni 39 (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET.pdf) dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (Evidenca Nr.7. Rregullore e programit të studimit BA "Informatike Ekonomike".pdf). Nëpërmjet tyre studentët informohen për kushtet që duhet të plotësojnë për tu regjistruar në punimin e Diplomës apo Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar. Sipas rregullores studenti duhet të ketë përfunduar detyrimet në dy vitet e para të studimeve dhe të ketë një notë mesatare sa paku 8.5. Studentët njihen me rregullat e diplomimit që në fillim të vitit të tretë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ u informua gjatë takimit me Përgjegjësin e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut se departamenti i cakton një udhëheqës për diplomim studentit, i cili e ndihmon studentin që në përzgjedhjen e temës deri në nxjerrjen dhe procesimin e rezultateve dhe shkrimin e projektit të diplomës. Gjatë takimit me studentët, përfaqësues të tyre që ishin në vitin e 3-të pohuan se ishin në kontakt të vazhduar me udhëheqësit e tyre dhe asistoheshin prej tyre për realizimin e Projektit të Diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas Rregullores së UET neni 39 dhe Rregullores së programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" pika 8, diplomimi i studentëve bëhet nëpërmjet mbrojtjes së punimit të Diplomës për studentët me mesatare së paku 8.5 dhe me Provim të Përgjithshëm Përfundimtar për studentët poshtë kësaj mesatareje. GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni (A. IV. "Sistemi i Vlerësimit të Studentit") konstaton se institucioni ka hartuar rregullat për hartimin e tezës së provimit final, njohuritë që duhet të testohen dhe peshën e secilës tipologji të lëndëve. Provimi përmban njohuri të dhëna gjatë gjithë viteve akademike dhe përfshin të gjithë modulet bazë.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.	Bazuar tek dokumenti "Mbi punimin e diplomës/disertacionit", GVJ konstaton se brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit të tretë akademik, studentët pajisen nga departamenti me formularin e aplikimit për temën e diplomës shoqëruar me listën e pedagogëve të mundshëm udhëheqës dhe me inventarin e temave të propozuara. Studenti

Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	që fiton të drejtën e përfundimit të studimeve me punim diplome ndjek seancat metodologjike me pedagogun udhëheqës. Seancat metodologjike janë orë në auditor, të cilat konsiderohen formalisht si orë seminaresh, që kanë për qëllim të ndihmojnë studentët në aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. (Evidenca Nr. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf).
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ u informua në takimin me studentët që ishin në vitin e tretë dhe stafin akademik, të cilët pohuan se studentëve ju vihen në dispozicion burimet e nevojshme për realizimin me sukses të Projektit të Diplomimit. Për vetë natyrën e këtij programi ata përdorin kryesisht laboratorët e informatikës, software të ndryshëm specifikë që lidhen me programin e studimit, platformat online për të bërë kërkime të specializuara, etj.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar tek Plani Mësimor dhe dokumenti "Mbi punimin e diplomës/disertacionit", GVJ konstaton se pas përfundimit të mbrojtjes së Diplomës ose Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, studenti vlerësohet me notë sipas sistemit të notave të përdorur në UET dhe fiton 7 kredite ECTS. (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për anakes_RVB Plani mësimor sipas kategorive Tabela 9.pdf, Evidenca Nr. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf).
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Mbështetur tek dokumenti "Mbi punimin e diplomës/disertacionit" por edhe tek informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se pasi studenti mbron diplomën apo jep provimin përfundimtar, Sekretaria Mësimore bën verifikimet e rezultateve të studentit (për gjithë studimet) dhe të përmbushjes së të gjitha detyrimeve të tij. Brenda 6 muajve studenti pajiset me Diplomën përkatëse dhe me Suplementin e Diplomës. GVJ konfirmon, bazuar tek dokumentat e shqyrtuara, që Diploma Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është e miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Çdo diplomë, përpara se të lëshohet nga UET regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi. (Evidenca Nr. 15. Model Diplome_Suplement Udhëzimi 11 - BSc Informatikë Ekonomike_shqip.pdf). Me kërkesë të studentit atij i vihet në dispozicion edhe kopje e plotë zyrtare e programit të studimit që ka ndjekur, e firmosur dhe vulosur nga titullari i institucionit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ u informua gjatë vizitës në sekretarinë mësimore se pas përfundimit të studimeve, një kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në bazë të Rregullores së Arkivë Protokollit, dokumentat ruhen nga Zyra e kontratave dhe Sekretaria Mësimore sipas kriterëve përkatëse. (Evidenca Nr.9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf).			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një rregullore të posaçme për diplomimin në të cilën janë të paraqitura në mënyrë të detajuar të gjitha çështjet që lidhen me procesin e diplomimit për të gjitha nivelet e programeve të studimit, që nga zgjedhja e temës, udhëheqësi, seancat metodologjike, struktura e punimit, procedurat e mbrojtjes, etj. Diplomimi i studentëve bëhet nëpërmjet mbrojtjes së punimit të Diplomës për studentët me mesatare së paku 8.5 dhe me Provim të Përgjithshëm Përfundimtar për studentët poshtë kësaj mesatareje. Departamenti i cakton një udhëheqës për diplomim studentit, i cili e ndihmon studentin që në përzgjedhjen e temës deri në nxjerrjen dhe procesimin e rezultateve, dhe shkrimin e projektit të diplomës. GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni (A. IV. "Sistemi i Vlerësimit të Studentit") konstaton se institucioni ka hartuar rregullat për hartimin e tezës së provimit final, njohuritë që duhet të testohen dhe peshën e secilës tipologji të lëndëve. Provimi përmban njohuri të dhëna gjatë gjithë viteve akademike dhe përfshin të gjithë modulet bazë. Pas përfundimit të mbrojtjes së Diplomës ose Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, studenti vlerësohet me notë sipas sistemit të notave të përdorur në UET dhe fiton 7 kredite ECTS. Pas përfundimit të studimeve, brenda 6 muajve studenti pajiset me Diplomën përkatëse dhe me Supplementin e Diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

¹ Evidenca Nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Amel *Ed*

Prof.Dr.	0	0	0	0	0	0
Prof.As.	0	0	0	0	0	0
Dr./PhD.	5	1	2	2	2	1
MSc. (proc. Dr)	0	0	3	0	8	1
MSc.	5	0	6	2	4	4
Totali	10	1	11	4	14	6

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitin 2023-2024 ka kualifikimin si më poshtë:

Shqip:

- 4 pedagogë me titullin Prof. Dr.
- 3 pedagogë me titullin Prof. Asoc. Dr.
- 8 pedagogë me gradën shkencore Dr.
- 15 pedagogë me gradën shkencore MSc. që janë në proces doktrate
- 10 pedagogë me gradën shkencore MSc.

Anglisht:

- 3 pedagogë me gradën shkencore Dr.
- 9 pedagogë me gradën shkencore MSc. që janë në proces doktrate
- 8 pedagogë me gradën shkencore MSc.

Gjatë takimit GVJ u vu në dijeni se rolin e personelin ndihmësakademik për këtë program studimi e luajnë punonjësit e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, të cilët kujdesen për instalimet e nevojshme, mirëmbajtjen e bazës laboratorike, përditësimet, etj.

Referuar planit mësimor (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor i programit BA Informatikë Ekonomike) dhe tabelave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi (Tabela 12 – Tabelat përmbledhëse) GVJ konstaton se, edhe pse programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në Fakultetin e Ekonomisë Biznesit dhe Zhvillimit, përqindja më e madhe e personelit të angazhuar në këtë program vjen nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë. Konkretisht për vitin akademik 23-24, personeli i angazhuar në këtë program studimi është si më poshtë:

- 53% nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë dhe Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (FIIA).
- 13% nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut.
- 20% nga Departamenti i Ekonomisë dhe Financës

	• 14% nga departamente të tjera të UET. Raporte të ngjashme ruhen edhe për ngarkesën mësimore. Konkretisht ngarkesa mësimore mbulohet si më poshtë: • 61% nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë dhe Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin në FIJA • 13% nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut • 13% nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës • 13% nga Departamente të tjera Nisur nga sa më sipër, <u>GVJ rekomandon që Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut të forcojë kapacitetet e tij akademike duke shtuar staf me profil në shkencat kompjuterike, me qëllim që programi bachelor në "Informatikë Ekonomike" të administrohet dhe zhvillohet në mënyrë më organike brenda departamentit dhe fakultetit. Kjo do të reduktonte varësinë nga departamente dhe fakultete të tjera, duke siguruar një integritet më të natyrshëm të disiplinave dhe një menaxhim më efikas të programit, çka do të lehtësonte avancimin e tij në përputhje me objektivat akademike dhe nevojat e tregut.</u>								
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” (shqip dhe anglisht), mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Referuar Rregullores për Burimet Njerëzore (Evidenca Nr. 11.), përgjegjësi i departamentit përgjigjet për shpërndarjen e ngarkesës tek personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe raporton për këtë shpërndarje tek Zyra e Burimeve Njerëzore në fillim të çdo semestri (Evidenca Nr. 11.2. Formulari i planifikimit të ngarkesës nga departamenti). Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Tabela 12 – Tabelat përmbledhëse), u konstatua se për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Shpërndarja e ngarkesës për tre vitet akademike për këtë program studimi (shqip+anglisht) është sipas tabelës më poshtë: <table><tr><td></td><td>2021-2022</td><td>2022-2023</td><td>2023-2024</td></tr><tr><td>PAE/PAK</td><td>91% / 9%</td><td>76% / 24%</td><td>81% / 19%</td></tr></table> Gjatë vizitës në institucion, GVJ u vu në dijeni se personeli akademik, veç angazhimit akademik, shpesh herë është i angazhuar edhe në detyra administrative brenda institucionit.		2021-2022	2022-2023	2023-2024	PAE/PAK	91% / 9%	76% / 24%	81% / 19%
	2021-2022	2022-2023	2023-2024						
PAE/PAK	91% / 9%	76% / 24%	81% / 19%						
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ vëren se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është përgjithësisht i qëndrueshëm. Kjo gjë u konstatua edhe gjatë								

qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	vizitave në institucion, ku GVJ u njoh me disa kontrata pune të personelit efektiv dhe personelit me kontratë. Po ashtu, referuar tabelave ku paraqitet personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi (Tabela 6 dhe 12 – Tabelat përmbledhëse), vërehet se përgjithësisht i njëjti personel akademik është angazhuar gjatë tre viteve të periudhës së akreditimit. Referuar Rregullores për Burimet Njerëzore (Evidenca Nr. 11.) dhe statutit të UET (Evidenca Nr. 2. Statuti i UET), si dhe diskutimeve gjatë vizitave, kontratat individuale të punës të lidhura mes UET dhe personelit akademik efektiv, janë në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, Neni 59.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitën e kryer në institucion, GVJ konstaton se rekrutimi i personelit akademik bëhet përmes një procesi përzgjedhjeje transparent dhe të mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura (Evidenca Nr. 11.1. Shembull thirrje për staf akademik; Evidenca Nr. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore). Personeli akademik përzgjidhet me konkurim pas shqyrtimit nga një komision rekrutimi që ngrihet me urdhër të Rektorit. Përzgjedhja bëhet në përputhje me kriteret specifike të kualifikimit, duke përdorur një sistem pikëzimi për rankimin e kandidatëve, për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori (Evidenca Nr. 2. Statuti i UET). Gjatë takimit me zyrën e burimeve njerëzore, GVJ u vu në dijeni se gjatë procesit të rekrutimit, kandidatëve mund t'i kërkohej të zhvillojnë një leksion të hapur në prani të personelit akademik të UET. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si gjatë momentit të rekrutimit, ashtu edhe në vijim.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vizita në institucion, GVJ mori informacion mbi personelin ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi për zhvillimin e orëve laboratorike. Sipas informacionit të dhënë, personeli i departamentit të IT-së është i angazhuar për të siguruar zhvillimin normal të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të laboratorëve. Orët laboratorike zhvillohen nga personeli akademik, të asistuar, sipas nevojës, nga personeli i IT-së. Gjithashtu, GVJ u vu në dijeni se UET ka miratuar përfshirjen në organikë të një personeli të dedikuar ndihmës akademik. Orët laboratorike realizohen në laboratorë. Institucioni ofron mjedise moderne me aparatura, mjete dhe programe aplikative të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor (Evidenca Nr. 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit)

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit në institucion, GVJ konstatoi se zyra e burimeve njerëzore në UET mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Gjatë vizitës GVJ shqyrtoi dosje të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Në dosjen e personelit akademik efektiv u gjendën këto dokumenta: • Kontrata individuale e punës; • Formulari për Vlerësimin të pedagogut nga autoritetet drejtuese dhe nga studentët; • CV-ja • Dokumenti i identifikimit (fotokopje e kartës së identitetit); • Diploma e arsimit të lartë të kryer, si dhe dokumenta të tjera kualifikimi, përfshirë gradat akademike, të noterizuara • Libreza e punës; • Libreza shëndetësore; • Raporti mjeko ligjor; • Certifikime të trajnimeve të ndryshme Në dosjen e personelit akademik me kohë të pjesshme u gjendën këto dokumenta: • Kontrata individuale e punës; • Formulari i Vlerësimin të pedagogut nga autoritetet drejtuese dhe nga studentët; • CV-ja • Dokumenti i identifikimit (fotokopje e kartës së identitetit); • Diploma e arsimit të lartë të kryer, si dhe dokumenta të tjera kualifikimi, përfshirë gradat akademike, të noterizuara • Leja nga punëdhënësi kryesor për mësimdhënie në UET; • Vërtetimi i pagës, që përmbante emrin dhe mbiemrin e pedagogut, detyrën që kryen në institucion, NIPT-in e institucionit, pagën bruto mbi bazën e të cilës llogariten kontributet, datën e lëshimit; • Librezën shëndetësore; • Raportin mjeko ligjor; • Certifikime të trajnimeve të ndryshme. Personeli akademik dorëzon pranë zyrës së burimeve njerëzore realizimin e ngarkesës sipas formatit të kërkuar G.II.2.1. (Evidenca Nr. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet
--	--

	njerëzore; Evidenca Nr. 11.2. Formulari i planifikimit të ngarkesës nga departamenti). Referuar Dokumentit F.IV-F.V, Drejtuesi i Departamentit menaxhon të dhënat e personelit dhe shpërndan në mënyrë optimale ngarkesën mësimore (Evidenca Nr. 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit).
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe diskutimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UET ka nënshkruar dhe ka efektive një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, biznese, organizata e qendra zhvillimi, përmes të cilave realizon praktikat profesionale. (Evidenca Nr. 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale; Evidenca Nr. 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale). Praktikrat profesionale vlerësohen nga një komision që ngrihet nga departamenti për mbrojtjen e praktikës nga studentët. Në përfundim të praktikës studentët përgatisin një punim dhe e prezantojnë atë para komisionit. Për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, praktika profesionale e zhvilluar gjatë vitit akademik 2023 – 2024 ka patur më shumë orë në auditor se në institucion, ndërsa për këtë vit akademik gjatë diskutimeve me personelin akademik dhe Drejtuesin e Departamentit u theksua se do të ulen orët në auditor duke shtuar orët/ditët e zhvillimit të praktikës në institucion. GVJ e mbështet këtë qasje. Studentët që zhvillojnë temë diplome, udhëhiqen nga një pedagog të caktuar nga drejtuesi i departamentit.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara mes UET dhe institucioneve bashkëpunuese (Evidenca Nr. 34.1 – 34.14: Marrëveshjet e bashkëpunimit) si dhe sipas përcaktimeve në dokumentin mbi praktikën profesionale (Evidenca Nr. 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale), personeli mbikqyrës në institucionin ku zhvillohet praktika profesionale angazhohet dhe ndihmon studentin për përmbushjen e detyrimeve të praktikës si dhe merr pjesë në vlerësimin e tyre për praktikën profesionale. Praktika profesionale është 5 ECTS, 125 orë pune, nga të cilat 28 orë zhvillohen në auditor, 72 orë në institucion dhe 25 orë punë individuale.
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, përmbush kriteret</i>

	ligjore në fuqi, duke patur nivelin e duhur të kualifikimit dhe duke mbuluar ngarkesën mësimore. Institucioni dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi si dhe zbaton procedura rekrutimi të hapura, duke garantuar një proces transparent dhe objektiv dhe në përputhje me kërkesat e departamentit përgjegjës. Të dhënat në lidhje me personelin mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. UET ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi dhe u mundëson studentëve të këtij programi zhvillimin e praktikave mësimore. Personeli akademik është i angazhuar në praktikën profesionale dhe ndihmon, informon dhe mbikqyr studentët në realizimin e tyre. Për të siguruar një zhvillim më të qëndrueshëm dhe afatgjatë të programit, GVJ vlerëson të nevojshme që Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut të zgjerojë kapacitetet e tij akademike me staf të specializuar në shkencat kompjuterike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka siguruar mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Konkretisht, UET ka aktualisht në përdorim 57 salla mësimore, (25 salla laboratorë, 18 salla për seminare dhe 14 salla leksioni) dhe dy palestra. Në godina ndodhen gjithashtu edhe salla për veprimtari të ndryshme, biblioteka, zyra e informacionit, etj. (Evidenca Nr. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr.Xhanfize Keko_Extract)
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të	Pas shqyrtimit të dokumentacionit (Evidenca Nr. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr.Xhanfize Keko_Extract) dhe vizitës së zhvilluar, rezulton se mjediset në dispozicion të këtij programi mësimor janë të bollshme dhe të pajisura me PC, projektorë, foni, sistem

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	kondicionimi, sinjal WIFI, software-t përkatës, etj., të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në funksion të programit të studimit janë disa laboratorë ku zhvillohen si orët mësimore në formën e leksioneve, leksione të ndërthurura me seminarët dhe laboratorët, duke iu mundësuar studentëve një qasje interaktive dhe bashkëkohore në mësimnxënie. Konkretisht, referuar dokumentit "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit" (Evidenca Nr. 42), si dhe nga inspektimi i kryer në institucion, procesi mësimor zhvillohet në laboratorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni, si dhe me softwarët përkatës përfshirë sistemin e shfrytëzimit (Windows 10), paketën MS Office 365, MS Teams, si dhe framework-et për zhvillimin e lëndëve të profilit si Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrains; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj. Laboratorët janë gjithashtu të pajisur me mjetet didaktike për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja, përditësimi i pajisjeve kompjuterike dhe i programeve bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni disponon shtatë laboratorë informatike dhe që janë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Të gjithë laboratorët janë të pajisur me PC dhe projektor si dhe me mjete didaktike për zhvillimin e mësimin. Në PC janë të instaluar sistemet bazë si sistemi i shfrytëzimit, paketa MS Office 365, si dhe framework të nevojshme për lëndë specifike të programit të studimit (Evidenca Nr. 42.1. Lista e laboratoreve).
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se UET ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Kampusi ofron disa godina në të cilat gjenden sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratorët, si dhe ambiente të tjera për veprimtaritë të ndryshme të institucionit. Godinat kanë sipërfaqe të bollshme, salla të ndriçuara, sistem kondicionimi si dhe mjetet didaktike dhe audio vizive. Laboratorët e teknologjisë së informacionit përdoren për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe orëve</i>

	laboratorike dhe janë të pajisura me mjete si PC, video projektor, foni, si dhe software-t e nevojshëm për zhvillimin e lëndëve të profilit të këtij programi studimi.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ, pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve, konstatoi se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është përgjithësisht e pesë viteve të fundit, është në përputhje me lëndën dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit (Evidenca Nr. 19. Syllabus). Megjithatë, nga shqyrtimi i inventarit të fondit të bibliotekës, u vu re se literatura, veçanërisht ajo për lëndët e profilit të teknologjisë së informacionit, nuk është e disponueshme në bibliotekë. Gjatë takimeve në institucion, si pedagogët ashtu edhe studentët konfirmuan se literatura iu vihet në dispozicion studentëve nga pedagogët në format elektronik përmes sistemit LMS. Përveç literaturës bazë, pedagogët pajisin studentët edhe me materiale të përmbledhura (prezantime rreth 10 faqe) në shqip ose anglisht, sipas gjuhës së zhvillimit të programit. Për të siguruar një qasje më të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj materialeve mësimore, <u>GVJ rekomandon që të paktën literatura e detyrueshme të jetë e disponueshme dhe aksesueshme edhe në bibliotekë.</u>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve (Evidenca Nr. 19. Syllabus) rezulton se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është e viteve të fundit, duke përmbushur kriterin për përditësimin e literaturës. UET ka një praktikë funksionale për vlerësimin e programeve të lëndëve (syllabuseve) (Evidenca Nr. 37. Formati_Raporti i Vlerësimit të Programeve të Lendëve; Evidenca Nr. 37.1. Shembull Raporti i vlerësimit të silabuseve 24-25), gjatë së cilës bëhet edhe rishikimi i literaturës për të siguruar që ajo është e përshtatshme për lëndën dhe përfshin botimet më të fundit. Ky proces kryhet në fillim të çdo semestri. Gjithashtu, sipas dokumentit mbi funksionimin e bibliotekës (Evidenca Nr. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës), personeli akademik mund të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	paraqesë kërkesa për literaturë të re tek drejtuesi i departamentit përkatës, i cili më pas i përcjell ato tek Përgjegjësi i Bibliotekës për shqyrtim. Procesi i blerjes së librave kërkon miratimin e administratorit të institucionit.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV dhe gjatë vizitës GVJ vuri re se në institucion ka një sallë biblioteke. Në sallë ka 41 vende leximi, disa PC në dispozicion të studentëve për të aksesuar bibliotekat online si dhe raftë ku janë vendosur një pjesë e librave (Evidenca Nr. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr.Xhanfize Keko_Extract). Biblioteka qëndronte e hapur për studentët dhe jashtë orarit të procesit mësimor dhe studentët asistohen nga një personel i dedikuar. Ambienti është i bollshëm, i ajrosur dhe i ndriçuar.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se biblioteka është e pajisur me tekste universitare, libra, revista shkencore apo botime të tjera në gjuhë shqipe dhe të huaj, të lidhura me të gjitha programet e studimit që ofrohen në institucion. Për shkak të hapësirës së kufizuar, në bibliotekë mbahen vetëm një pjesë e librave, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në arkivë dhe aksesohet sipas kërkesës. Referuar dokumentacionit të paraqitur, biblioteka ka në total 9949 tituj (Evidenca Nr. 45.5. Lista e arkivave dhe koleksioneve shkencore), nga të cilat 1707 janë në funksion të këtij programi studimi (Evidenca Nr. 45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit). Biblioteka ka akses në tre platforma elektronike: SAGE; EBSCO dhe Research4Life si për studentët dhe personelin akademik. Referuar inventarit të paraqitur për këtë program studimi, GVJ vëren se biblioteka ka një fond të kufizuar që i përgjigjet 5 viteve të fundit. Për sa më lart, <u>GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës të pasurohet me literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare që i përgjigjet 5 viteve të fundit. Përditësimi të jetë periodik dhe t'i përgjigjet ndryshimeve në fushën e teknologjisë së informacionit të përfshirë në këtë program studimi.</u>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka ndodhet në Godinën A të kampusit dhe është e aksesueshme nga të gjithë studentët. Në sallë janë të vendosura edhe disa kompjutera që mund të përdoren nga studentët për të aksesuar fondin online. Shërbimi i internetit WIFI ofrohet në të gjithë kampusin, përfshirë bibliotekën, pa pagesë për të gjithë studentët. Studentët mund të aksesojnë bibliotekat online SAGE, EBSCO dhe Research4Life, pa pagesë duke përdorur kredencialet e ofruara nga institucioni.

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se biblioteka është e pajisur me kompjuterë dhe programe të nevojshme për përdorim nga studentët. Përveçse një burim informacioni, ambientet e bibliotekës shërbejnë edhe si hapësira studimi, të cilat janë të hapura për të gjithë studentët e institucionit. Gjithashtu, studentët mund të marrin asistencë nga personeli i dedikuar në bibliotekë.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar dokumentit mbi funksionimin e bibliotekës (Evidenca Nr. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës), konfirmuar gjithashtu edhe gjatë takimit me studentët dhe punonjësit e bibliotekës, ambientet e bibliotekës janë të hapura çdo ditë javë 9:00-20:00, si dhe ditën e shtunë 10:00 - 17:00. Gjatë sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës është me orar të zgjatur, duke iu përgjigjur kështu nevojave të studentëve. Aksesit në bibliotekat online është pa kufizim.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sipas dokumentit mbi funksionimin e bibliotekës (Evidenca Nr. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës), biblioteka dhe njësitë përgjegjëse për programin e studimit raportojnë për cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës, shkallën e shfrytëzimit të fondit, pasurimin e tij, etj. Megjithëse ekziston një procedurë e qartë dhe e mirëpërcaktuar për këtë proces, është vënë re se ka mangësi në literaturën e disponueshme në bibliotekë, veçanërisht në lëndët e profilit të teknologjisë së informacionit. Për këtë arsye, <u>rekomandohet një koordinim më i ngushtë dhe një përpjekje më e madhe për pasurimin e fondit të bibliotekës, në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e plotë për studentët dhe personelin akademik.</u>
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konstaton se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është e përditësuar dhe është në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Megjithatë, janë konstatuar mangësi në disponueshmërinë e literaturës për lëndët e</i>

	teknologjisë së informacionit në bibliotekë. Për këtë arsye, GVJ rekomandon një përpjekje më të madhe për pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të fundit, si dhe një koordinim më të ngushtë ndërmjet njërive dhe personelit akademik për të plotësuar kërkesat e studentëve dhe stafit. Përsa i përket shfrytëzimit të fondit të bibliotekës, GVJ konstaton se institucioni ofron një bibliotekë me mjedise të përshtatshme dhe të aksesueshme, me një staf të dedikuar që asiston studentët dhe akses në tri platforma elektronike. Salla siguron kompjutera të disponueshëm për studentët për të aksesuar burimet online.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Të dhënat për studentët, përveçse në regjister, regjistrohen edhe elektronikisht në Sistemin e Menaxhimit të Universitetit (UMIS) (Evidenca Nr. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS). Sistemi siguron konfidencialitet, siguri dhe integritet për të dhënat e ruajtura (Evidenca Nr. 2. Statuti UET; Evidenca Nr. 16. A.II. Kodi i Etikës). Të dhënat e regjistruara në sistem verifikohen për saktësi para diplomimit. UET përdor edhe sistemin LMS i integruar me sistemin UMIS, përmes të cilit studentët njihen me procesin mësimor.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka vënë në dispozicion një bazë të dhënash "Dokumenta UET" ku çdo anëtar i institucionit mund të aksesojë të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, etj., lidhur me aktivitetin e institucionit. Aktiviteti akademik menaxhohet përmes sistemit LMS, në të cilin kanë akses si personeli akademik ashtu edhe studentët. Në këtë sistem ka të dhëna lidhur me veprimtarinë mësimore si materialet, detyrat e kursit, tezat e provimit, rezultatet e vlerësimit etj. Institucioni ofron gjithashtu edhe e-mail për personelin dhe studentët. (Evidenca Nr. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS; Evidenca Nr. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun)
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në	Akcesi në bazën e të dhënave "Dokumenta UET" ofrohet pa kufizim për të gjithë personelin e institucionit. Akcesi në sistemet e menaxhimit UMIS dhe LMS ofrohet me nivele të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	ndryshme aksesit, ku autorizimi bëhet në bazë të rolit të përdoruesit. Studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit përkatës (Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni përdor disa platforma elektronike për të mundësuar komunikim virtual mes personelit akademik dhe studentëve, si sistemin LMS, MS Teams dhe email. Komunikimi për procesin mësimor bëhet kryesisht përmes sistemit LMS, ku studentët informohen mbi lëndët, orarin, rezultatet, etj. Institucioni ofron guida përdorimi për këto sisteme si dhe trajnime të dedikuara (Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet; Evidenca Nr. 46.4. Video-trajnime mbi sistemin TEAMS-LMS)
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Përdorimi i platformave elektronike si LMS dhe MS Teams për menaxhimin e procesit mësimor, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit të çdo pedagogu. Përmes këtyre platformave mund të merret informacion i saktë dhe në kohë reale mbi ngarkesën mësimore të zhvilluar, detyrat e realizuara nga studentët, vlerësimet, etj.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ kontrolloi faqen e internetit dhe vuri re se informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në të paktën dy gjuhë, përfshirë gjuhën shqipe. Megjithatë, u vërejt se informacioni për programin e studimit nuk është i plotë. Në faqen e internetit është publikuar vetëm programi i studimit, por nuk ka informacione të tjera të dobishme mbi përmbajtjen e lëndëve dhe detaje të tjera të nevojshme për studentët dhe personelin akademik. <u>GVJ rekomandon që informacioni në faqen e internetit të jetë më i plotë, duke ofruar informacion që i ndihmon studentët dhe të interesuarit të kuptojnë përmbajtjen e programit të studimit.</u> ²
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UET ka implementuar një sistem të menaxhimit të informacionit të centralizuar që mbulon regjistrimin, monitorimin dhe administrimin e të dhënave të studentëve dhe personelit akademik. Ky sistem integron përdorimin e platformave si UMIS, LMS dhe MS Teams për menaxhimin e aktiviteteve akademike dhe administrative, duke mundësuar akses të dedikuar dhe komunikim interaktiv mes personelit dhe studentëve. Sistemi gjithashtu ofron mundësi

² <https://uet.edu.al/bachelor/>

	për monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe mundëson raportime të detajuara për organet drejtuese. Lidhur me publikimin e informacionit në web, u vërejt se faja e internetit ka informacion të publikuar në dy gjuhë, përfshirë gjuhën shqipe, por ka mangësi në informacionin për programin e studimit. GVJ rekomandon që ky informacion të plotësohet për të ofruar një pasqyrë më të plotë dhe të dobishme për përdoruesit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe në vijim të vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni harton dhe miraton çdo vit buxhetin, në të cilin përcaktohen shpenzimet mujore duke ruajtur një raport të drejtë mes të ardhurave dhe shpenzimeve (Evidencat Nr. 50.1.; 50.2.; 50.3. Pasqyrat Financiare). Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e shkollimit, si dhe kontribute nga grante dhe projekte të ndryshme ku merr pjesë UET. Shpenzimet e programit lidhen kryesisht me shpenzimet për personelin akademik, mirëmbajtjen e mjediseve, kostot për studentë (Tabela Nr. 18.1 - Tabelat Përmbledhëse) etj.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se institucioni respekton standardet e hartimit të buxhetit dhe raportimit financiar. Në pasqyrat financiare të vëna në dispozicion për të tre vitet e akreditimit (Evidencat Nr. 50.1.; 50.2.; 50.3. Pasqyrat Financiare), vërehet se institucioni ka kryer shpenzime për mirëmbajtjen e mjediseve, bibliotekën, pasurimin e literaturës dhe aksesin në biblioteka online, shpenzime për personelin, pagesën e kontratave të lidhura në funksion të programit të studimit dhe zëra të tjerë që lidhen me aktivitetin e institucionit.

online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar Statutit të UET, Neni 54, pikat 64.5 dhe 64.6 (Evidenca Nr. 2. Statuti UET), institucioni i nënshtrohet çdo vit auditimit të brendshëm nga njësia e auditimit të brendshëm të institucionit dhe auditimit të jashtëm me auditues të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar nga Ministria e Financave. GVJ konstaton se institucioni i është nënshtroar auditimit për gjendjen dhe aktivitetin e tij financiar për të tre vitet e akreditimit (Evidencat Nr. 50.4., 50.5. dhe 50.6. Raporte auditimi për vitet 2021, 2022 dhe 2023). Për pasqyrat financiare, audituesi ka dhënë opinion lidhur me situatën financiare, performancën dhe përputhjen me standardet e kontabilitetit.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Menaxhimi financiar dhe zbatimi i politikës financiare të institucionit janë përgjegjësi e Zyrës së Financës dhe Kontabilitetit. Kjo zyrë siguron që të gjitha proceset financiare, nga administrimi i të ardhurave dhe realizimi i investimeve deri te kryerja e shpenzimeve dhe pagesave, të zhvillohen në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse, duke mbuluar edhe nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. (Evidenca Nr. 2. Statuti UET)
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ vëren se institucioni tregon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e këtij programi studimi dhe ecurinë normale të tij (Evidencat Nr. 50.1.; 50.2.; 50.3. Pasqyrat Financiare). Gjatë të treja viteve të akreditimit, institucioni ka akorduar edhe bursa për studentët (Tabelat 25 – Tabelat Përmbledhëse)

Konkluzione	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ ka vërejtur se UET, përmes strukturave të tij, kryen planifikimin financiar të njësisë kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit. Ky proces përfshin identifikimin e nevojave, të cilat më pas integrohen në buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit. Nevojat e identifikuar përfshijnë aspekte infrastrukturore, kërkimore-shkencore, didaktike, etj. Gjithashtu, institucioni ka ngritur mekanizma të efektshëm të auditimit të brendshëm dhe realizon auditime të jashtme. Pasqyrat financiare reflektojnë qëndrueshmëri financiare të institucionit, duke garantuar vijimësinë e programit në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton një paketë aktesh të brendshme që rregullojnë procesin e pranimit, ndjekjes dhe diplomimit të studentëve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Këto përcaktohen edhe në statutin e UET (Evidenca Nr. 2. Statuti UET) dhe përfshijnë Rregullore akademike, rregullore të programit të studimit, si dhe rregullore dhe procedura të tjera për zhvillimin e programit dhe marrëdhëniet me studentët (Referenca Nr. 5. Rregullore UET; Evidenca Nr. 25.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Evidenca Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA "Informatike Ekonomike").
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në	GVJ vëren se aktet e institucionit garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në programin




dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET). Këtë program studimi mund ta ndjekin studentë shqiptarë ose të huaj, kriteret e pranimi për të cilët janë të njëjta. Në përfundim të këtij programi, studentët kanë të drejtë të diplomohen dhe pajisen me diplomë universitare Bachelor në “Informatikë Ekonomike”.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UET (Evidenca. Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”; Evidenca Nr. 5. Rregullore UET) përcaktohen kriteret e pranimi të kandidatëve shqiptarë dhe të huaj për pranim në këtë program studimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni mund të vendosë edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve. Kriteret e pranimi përcaktohen gjithashtu edhe në rregulloren e UET.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit në studime, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të përcaktuara hollësisht në rregulloret e brendshme të institucionit dhe në dokumentacionin e programit të studimit (Evidencat. Nr. 7. ³ ; 5. ⁴ ; 25.1. ⁵ ; 26. ⁶). Këto rregulla sigurojnë transparencë dhe udhëzime të qarta për studentët. Megjithatë, nga kontrolli që GVJ i bëri faqes zyrtare të UET (www.uet.edu.al), ky informacion nuk u gjet i publikuar. Për këtë arsye, <u>GVJ sugjeron që informacioni mbi kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit të publikohet edhe në faqen e internetit të institucionit dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm për publikun, duke siguruar një qasje më të thjeshtë dhe të qartë për të gjithë të interesuarit.</u>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ u informua lidhur me qasjen që UET ndjek për informimin e të interesuarve mbi programet e studimit që ofron, përpara nisjes

³ 7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”

⁴ 5. Rregullore UET

⁵ 25.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve

⁶ 26. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin

publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	së vitit akademik. GVJ konstatoi se përpara fillimit të çdo viti akademik UET ndërmerr një sërë aktiviteteve si takime me studentë potencialë (gjimnaz tour), zhvillon aktivitetin Open Days me maturanët, si dhe ofron këshillim të vazhdueshëm përmes zyrës së pranimeve, këshilluesit e karrierës, etj. (Evidenca Nr. 26. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin; Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Evidenca Nr. 25.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UET nuk aplikon kriteret shtesë për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", veç atyre të përcaktuara në legjislacion (Evidenca Nr. 25.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UET pranon regjistrime dhe transferime të studentëve nga vende të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkollat të tjera. Të njëjtat kriteret pranimi aplikohen si për shtetasit shqiptarë ashtu edhe për ato të huaj. (Evidenca Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA "Informatikë Ekonomike"; Evidenca Nr. 25.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Evidenca Nr. 26. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin)
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ vuri re se UET ofron bursa ose reduktim të tarifave të studimit për studentët, mbi bazën e disa kriterëve. Referuar tabelës 25 "Të dhëna për akordimet e bursave", GVJ konstaton se UET ka akorduar bursa të plota dhe të pjesshme (1/2 bursë) për studentët e programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" për të tre vitet në shqyrtim.
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UET ka hartuar dhe zbaton politika të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme, për procedurat e pranimit, përzgjedhjes, transferimin njohjen dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Këto politika janë të qarta dhe të hollësishme dhe garantojnë barazi për të gjitha kategoritë e studentëve, shtetas shqiptarë ose të huaj. GVJ ka konstatuar se disa informacione nuk janë të aksesueshme në faqen zyrtare të</i>

	<i>institucionit dhe rekomandon publikimin e tyre për të rritur transparencën.</i> <i>Institucioni përmes një sërë aktiviteteve dhe strukturash të brendshme informon dhe prezanton ofertën e tij akademike përpara çdo fillim viti akademik. Institucioni nxit dhe mbështet studentët me anë të bursave dhe reduktimit të tarifave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar rregullores së institucionit dhe rregullores së programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, si dhe nga shpjegimet e dhëna gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik si dhe kalimi nga njëri vit në tjetrin. Ky informacion është i specifikuar në rregullore si dhe i ofrohet studentëve nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës, tutoriatit dhe sekretarisë së institucionit. (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET; Evidenca. Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ vëren se në UET funksionojnë zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës, si dhe sekretaria mësimore, të cilat, ndër të tjera, ofrojnë informacion për të interesuarit lidhur me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Ky informacion është gjithashtu i përfshirë edhe në rregulloren e UET, rregulloren e programit të studimit dhe dokumentin e transferimeve (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET; Evidenca. Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”; Evidenca Nr. 26. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin). Sipas tyre, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, institucioni pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jo publike.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive. Ky

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	informacion është i përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit (Evidenca. Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA "Informatike Ekonomike"), si dhe në syllabuset e lëndëve (Evidenca Nr. 19. Syllabus), të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që në fillim të semestrit.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një dokument specifik për punimin e diplomës, në të cilin detajohet plani i diplomimit, që nga aplikimi për temë diplome, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës, procesi i shkrimit të tezës, kalendari i seancave metodologjike, e deri tek formati i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja (Evidenca Nr. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit). Në kalendarin akademik paraqiten edhe fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës (Evidencat Nr. 10.1, – 10.3. Kalendari akademik). Ky kalendar shpallet që në fillim të vitit akademik dhe është i aksesueshëm nga studentët.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET), konfirmuar edhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ vuri re se institucioni është vazhdimisht i angazhuar për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm përmes aktiviteteve të ndryshme që organizon si Ditët e Hapura, etj.
Konkluzione	<i>GVJ ka konstatuar se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në diplomimin e tyre. Ky informacion përfshihet në disa akte të institucionit, si dhe shpjegohet dhe detajohet hollësisht në dokumente specifike të hartuara për këtë qëllim. Këto dokumente ju vihen në dispozicion dhe janë të aksesueshme nga studentët. Paralelisht, institucioni ka ngritur disa mekanizma që ofrojnë këshillim dhe informacion të vazhdueshëm për studentët dhe të interesuar të tjerë, si para fillimit të vitit akademik ashtu edhe gjatë vitit. GVJ konstaton gjithashtu se institucioni organizon aktivitete të ndryshme informimi dhe promovimi të programeve të studimit që ofron. Institucioni ka detajuar kriteret e pranimit si dhe procedurat e transferimit të studimeve. Studentëve i vihet në dispozicion një dokument i detajuar për punimin e diplomës, i cili orienton dhe strukturon studentët për finalizimin më sukses të saj.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se studentët marrin informacion të plotë mbi programin e studimit që në fillim të vitit akademik. Informacioni gjendet në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” (Evidenca Nr. 7 dhe 7.1). Zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët japin informacion të vazhdueshëm për studentët mbi të gjithë elementët e programit të studimit (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Evidenca Nr. 5. Rregullore UET). Po ashtu, ky informacion është i disponueshëm për studentët edhe online, përmes sistemit LMS (Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni përdor disa mekanizma për t’u siguruar që studentët e programit të studimit të kenë informacion të detajuar mbi të. Tutoriati është njëri prej shërbimeve që iu ofrohet studentëve të ciklit të parë, për t’i ndihmuar në zhvillimin e tyre akademik. Po ashtu, institucioni ofron shërbim përmes këshillimit akademik (Evidenca. 25.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik). I gjithë dokumentacioni/udhëzuesit është i aksesueshëm nga studentët përmes zyrës së sekretarisë, koordinatorëve si dhe në sistemin UET LMS (Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet). Gjithashtu, studentët pajisen që në fillim të vitit me syllabuset e lëndëve, ku ka informacion të hollësishëm mbi lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese (Evidenca Nr. 19. Syllabus).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar dokumentacionit (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit), si dhe sipas informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Zyra e Këshillimit të Karrierës është aktive në ofrimin e informacionit, udhëzimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit. Shërbimet që ofrohen nga zyra përfshijnë ndihmë për hartimin e CV dhe dokumentave të tjera

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	për aplikim për një pozicion pune (letër motivimi, letër falenderimi, etj.), këshillim për fazën e intervistës, etj. Gjithashtu, zyra prezanton kalendarin e aktiviteteve të lidhura me industrinë, analizon planin e karrierës për studentët përmes sondazheve, si dhe kryen mentorim dhe networking.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ vëren se studentët kanë informacionin e duhur për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e ofruara. Këtë informacion e marrin në mënyrë të vazhdueshme përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kudesit ndaj Studentëve, sekretaria, koordinatorët si dhe përmes sistemit UET LMS (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Evidenca Nr. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet). Tutoriati dhe këshillimi akademik është një tjetër shërbim përmes të cilit studentët marrin informacion të detajuar (Evidenca. 25.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në institucion funksionon sistemi UET LMS në të cilin ndodhet i gjithë informacioni në lidhje me procesin mësimor. Çdo student pajiset me një llogari personale, përmes së cilës akseson këtë sistem sipas privilegjeve që i jepen. Sistemi i mundëson studentit të marrë informacion edhe në distancë (Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet).			
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, ka konstatuar se UET, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" informacion të hollësishëm mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit. Studentëve iu ofrohen manuale dhe udhëzues të posaçëm, që përmbajnë informacion të detajuar për lëndët, aktivitetet formuese dhe mundësitë akademike. Përmes strukturave administrative dhe shërbimeve si zyra e këshillimit të karrierës, studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës. Sistemi i menaxhimit të informacionit UET LMS i mundëson studentëve akses online dhe në distancë për të marrë informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor dhe aktivitete të tjera akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Referuar dokumentacionit dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni disponon statistika lidhur me numrin e studentëve dhe numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit. Ky informacion iu vu në dispozicion GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore (Evidenca Nr. 29. Monitorimi i ecursisë së studentëve diplomimit dhe punësimit të tyre - Informatikë Ekonomike; Evidenca Nr. 29.1. Extract Raporti Vjetor 2023 - 2024_Të dhëna për gjurmimin e studentëve të diplomuar të v.a.2022-2023; Evidenca Nr. 25. Tabela 21. Cilesia ne Hyrje Informatike Ekonomike).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Përmes sekretarisë mësimore, institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet, pezullimet etj. Sekretaria mësimore disponon dhe administron regjistrat e posaçëm. Të dhënat në regjister përpunohen dhe përditësohen, sipas proceseve institucionale (Evidenca Nr. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore). Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi (shqip+anglisht) për 4 vitet e fundit akademike (Evidenca Nr. 25. Tabela 21. Cilesia ne Hyrje Informatike Ekonomike), të verifikuara nga GVJ edhe në regjistrin themeltar në sekretarinë mësimore, janë si më poshtë: • 2021-2022: 40 studentë • 2022-2023: 87 studentë • 2023-2024: 104 studentë • 2024-2025: 87 studentë
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni ruan të dhëna elektronike në sistemin e menaxhimit të brendshëm lidhur me ecurinë e studentëve gjatë gjithë ciklit të programit të studimit, që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Në sistem ruhen të dhëna të tilla si prezenca, vlerësimi, stadi ku ndodhet studenti, etj. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit UMIS (Evidenca Nr. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS). Aksesit në sistem është me nivele sigurie dhe sipas roleve të përdoruesve, duke garantuar që të dhënat mund të aksesohet vetëm nga personel i autorizuar.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte,	Bazuar në aktet e brendshme (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë), institucioni

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritetë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	mbështet kontrollin periodik të njësive. Megjithatë, në RVB nuk argumentohet si kryhet ky proces nga institucioni. Gjithashtu, institucioni nuk ka paraqitur një evidencë apo raport që dokumenton se kryhet një proces për vlerësimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit. <u>GVJ sugjeron që institucioni të kryejë në mënyrë periodike dhe të dokumentojë procesin e kontrollit periodik të përvitshëm të të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarinë mësimore, sistemin e brendshëm).</u>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar (Evidenca Nr. 29.1. Extract Raporti Vjetor 2023 - 2024 Të dhëna për gjurmimin e studentëve të diplomuar të v.a.2022-2023), GVJ vëren se raporti paraqet të dhëna të detajuara për studentët e diplomuar dhe nivelin e punësimit të tyre për secilin program studimi, përfshirë Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Megjithatë, ai nuk ofron masa konkrete për përmirësimin e treguesve të punësimit, dhe nuk përfshin të dhëna për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Ky informacion është paraqitur si dokument më vete (Evidenca Nr. 25. Tabela 21. Cilesia ne Hyrje Informatike Ekonomike).			
Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së kryer, ka konstatuar se institucioni, vë në dispozicion struktura të posaçme për mbledhjen, përditësimin dhe ruatjen e të dhënave mbi numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar, transferuar, çregjistruar, etj. Të dhënat ruhen në regjistrë si dhe elektronikisht përmes sistemit të menaxhimit UMIS dhe janë të sigurt dhe të verifikueshme. GVJ sugjeron që institucioni të kryejë dhe dokumentojë kontrollin periodik të njësive përgjegjëse për menaxhimin e këtyre të dhënave. Institucioni mban të dhëna për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve në programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" si dhe harton raport vjetor për gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe nivelin e punësimit të tyre. Sugjerohet që ky raport të ofrojë dhe masa konkrete për përmirësimin e treguesve të punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në rregulloren dhe statutin e institucionit (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET; Evidenca Nr. 2. Statuti i UET), përcaktohet që studentët përfshihen në strukturat vendimmarrëse dhe këshilluese, duke u organizuar në Këshill Studentor, fokus grupe për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve, etj. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në Senatin akademik, ku kryetari i Këshillit Studentor dhe dy studentë të tjerë janë anëtarë, si dhe në Dekanat, Këshillin e Etikës dhe Komisionin e Sigurimit të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët janë të përfshirë në mënyrë reale, konkrete dhe frytdhënëse në vendimarrje, këshillim dhe vlerësimin e procesit akademik. Kjo evidentohet edhe nga procesverbalet e mbledhjeve të departamentit ku studentët shprehin hapur mendimet e tyre (Evidenca Nr. 12.4. Mbledhje e hapur me studentet; Evidenca Nr. 6.2. Shembull_Procesverbal mbledhje departamenti_mbledhje e hapur departamenti me studentë), pjesëmarrja në fokus grupe (Evidenca Nr. 30.14. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve), pjesëmarrja në sondazhet online për vlerësimin e procesit akademik (Evidenca Nr. 40.1. Shembull_Vlerësimi nga studentët_online).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ vëren se angazhimi i studentëve në mbledhjet e hapura të organizuara nga departamenti si dhe pjesëmarrja e tyre në fokus grupe, u jep studentëve mundësinë të shprehen dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo rishikimit të programeve të studimit. Studentët kanë gjithashtu mundësi të paraqesin mendimet e tyre edhe online përmes sistemit LMS dhe MS Teams, si dhe duke komunikuar drejtpërdrejt me pedagogët.

Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe sipas diskutimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentëve iu mundësohet dhënia e mendimit mbi veprimtaritë e procesit mësimor. Kjo garantohej nga rregullorja e programit të studimit si dhe rregullorja e institucionit (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET; Evidenca. Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA “Informatike Ekonomike”), ku sanksionohet e drejta e studentit për t’u njohur me vlerësimin e detajuar të provimit, ankimimin e rezultatit, rishikimin dhe reflektimin nga ana e pedagogut përgjegjës. Pas çdo vlerësimi, organizohen seanca sqaruese, ku studentët njihen dhe kuptojnë vlerësimin. Po ashtu, në rast ankimimi, procedura që ndiqet është transparente dhe vlerësimi bëhet përmes një komisioni AD-hoc.			
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse është reale, konkrete dhe frytdhënëse dhe garantohej nga aktet e brendshme nënligjore. Studentët përfshihen në procesin e hartimit/rishikimit të programeve mësimore, vlerësimin e veprimtarive të procesit akademik, etj, përmes disa mënyrave, si mbledhjet e hapura të departamentit, fokus grupet, sondazhet online, etj. Procesi i vlerësimit është transparent dhe studentët kanë mundësi për t’u njohur me vlerësimin e detajuar, të marrin sqarimet e duhura dhe të ankimojnë vlerësimin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se në UET funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve, që ofrojnë shërbime për studentët sipas parashikimeve ligjore (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Evidenca Nr. 33.1. Të dhëna për shërbimet e kujdesit ndaj studentit dhe këshillimin e karrierës_Extract RV 2023-2024.). Informacioni për programin e studimit dhe dokumentacioni/udhëzuesit iu vihen

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	në dispozicion studentëve përmes sekretarisë, koordinatorëve, si dhe janë të aksesueshme përmes sistemit LMS (Evidenca Nr. 46.3. UET LMS Guide per studentet).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstaton se në UET funksionojnë disa njësi që kujdesen për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe i asistojnë në çështje të ndryshme lidhur me procesin mësimor dhe zhvillimin e karrierës. Ndër to përfshihen zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, zyra e projekteve dhe partneriteteve, sekretaria mësimore, koordinatorët, etj. (Evidenca Nr. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore). Një mjet i rëndësishëm është sistemi LMS që ofron informacion të përditësuar për studentët, si dhe email-i, një tjetër mjet informimi që përdoret gjerësisht.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit nga Studentit është përgjegjëse për ofrimin e këshillimit të karrierës për studentët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se kjo zyrë kryen një shërbim shumë të mirë për të orientuar dhe këshilluar studentët për avancimin e tyre në karrierë (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit). Gjithashtu, kjo zyrë luan rol kyç në orientimin e studentëve për praktikën profesionale dhe orientimin në lidhje me tregun e punës (Evidenca nr. 25.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik).
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjurmimi i studentëve të diplomuar kryhet përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve, si dhe përmes Shoqatës Alumni (Evidenca Nr. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit). Zyra mbledh dhe përpunon të dhëna mbi punësimin e studentëve dhe ia vë në dispozicion ato organeve drejtuese, studentëve, etj. (Evidenca Nr. 29. Monitorimi i ecursisë së studentëve diplomimit dhe punësimit të tyre - Informatikë Ekonomike; Evidenca Nr. 33.1. Të dhëna për shërbimet e kujdesit ndaj studentit dhe këshillimin e karrierës Extract RV 2023-2024). Mbledhja e informacionit bëhet përmes kontakteve kryesisht me telefon, email dhe pyetësor.



Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se në UET janë ngritur dhe janë funksionale procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin dhe këshillimin në karrierë të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve luan një rol të rëndësishëm dhe është mjaft aktive dhe efiçente. Procesi i informimit realizohet përmes zyrave të posaçme si dhe në mënyrë elektronike përmes sistemit të brendshëm, emailit, etj. Institucioni mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre dhe jua vë në dispozicion studentëve dhe organeve drejtuese. Rol të rëndësishëm në mbledhjen e këtyre të dhënave luan edhe Shoqata Alumni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Pas shqyrtimit të RVB, dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se UET i kushton një vëmendje të veçantë aftësimit dhe nxitjes së personelit akademik për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Trajnimi i personelit akademik është një prioritet i përcaktuar qartë edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të UET 2021-2025 (Evidenca Nr. 3.1.). Personeli trajnohet si për metodat e mësimdhënies, ashtu edhe për përvetësimin e rregullores së brendshme të UET dhe akteve të tjera mbi të cilat operon institucioni (Evidenca Nr. 33. Të dhëna për aktivitete dhe trajnime për stafin dhe studentet). Rëndësi e veçantë në institucion i është dhënë qasjes së mësimdhënies me në qendër studentin, për të cilën institucioni ka hartuar një politikë të posaçme (Evidenca Nr.3.5.




	Dokumenti SCL Teaching and Assessment Policy.pdf; Evidenca Nr. 3.6. Vendimi nr 9, date 06.07.2023 Per miratimin e dokumentit SCL Teaching and Assessment Policy.pdf). Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për këtë metodologji.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ vëren se personeli akademik i nënshtrohet vazhdimisht trajnimeve dhe vlerësimeve nga strukturat përgjegjëse në institucion, përmes të cilave bëhet identifikimi i nevojave dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të tyre (Evidenca Nr. 2. Statuti i UET). Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ u njoh me mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë që përdoren, konkretisht: • Vlerësimi në auditor (Evidenca Nr. 30.16. dhe 30.17. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu/shembull) • Vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët, përmes fokus grupeve, mbledhjeve të hapura, anketave dhe sondazhit online (Evidenca 30.13. Metodologjia e punës së KSBC_Fokus Grup; Evidenca Nr. 40. Dhe 40.1. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online/Shembull; Evidenca Nr. 12.4. Mbledhje e hapur me studentet) • Rezultatet e raporteve të KSBC të cilat i shpërndahen Rektoratit dhe Departamenteve përkatëse (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; Evidencat Nr. 30.9 – 30.12.⁷). Aktiviteti i KSBC kryhet mbi bazën e një plani vjetor (Evidenca Nr. 30.1. Plani veprimit KSBC) • Vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës (Evidenca 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik – 2022)
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Kjo mundësohet përmes pyetësorit anonim, i cili zhvillohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri. Në këtë formular, ndër të tjera, studenti shpreh mendimin e tij lidhur me metodat që përdor pedagogu gjatë procesit mësimor (Evidenca Nr. 40. Dhe 40.1. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online/Shembull). Rezultatet e pyetësorit përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të

⁷ 30.9. Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset; 30.10. Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve; 30.11. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset; 30.12. Shembull_Relacion DMM_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022

	institucionit si dhe vetë pedagogëve në mënyrë të personalizuar. Studentët mund të paraqesin ankesa përmes plotësimit dhe dorëzimit të formularit të aneksës (Evidenca Nr. 40.2. D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve), si dhe gjatë takimeve të hapura që zhvillohen, fokus grupeve, etj. Lidhur me vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e trajtimit të ankesave, rregullorja e brendshme e UET dhe Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET; Evidenca Nr. 7. Rregullore e programit të studimit BA "Informatike Ekonomike") përcaktojnë qartë procesin e ankimimit që ndiqet.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar Statutit të UET, njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore të universitetit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UET (Evidenca Nr. 2. Statuti UET). Rezultatet e vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë), ose nga zyra e IT-së në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET dhe personelit akademik përmes Përgjegjësave të Departamentit.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson se në UET promovohen shembuj të praktikave më të mira dhe personeli akademik nxitet për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo gjë u evidentua edhe gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, ku personellet pohuan se rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit lidhur me vlerësimin diskutohen në mbledhjet e departamentit ku promovohen shembujt pozitivë. Po ashtu, nevojat individuale për përmirësim diskutohen në takime individuale ndërmjet përgjegjës të departamentit dhe pedagogut.
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta si dhe mekanizma efektivë për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është aktiv dhe e realizon mirë këtë proces përmes vlerësimeve të rregullta, trajnimeve të vazhdueshme për stafin dhe analizës së rezultateve. GVJ evidenton si praktikë të mirë qasjen e mësimdhënies me në qendër studentin, e cila mbështetet institucionalisht dhe zbatohet në mënyrë efektive.</i> <i>Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit përmes pyetësorëve, fokus grupeve dhe mekanizmave të tjerë. Rezultatet e vlerësimeve të studentëve apo të vlerësimeve të tjera si follow-up, vlerësimi në auditor, etj., përpunohen dhe i komunikohen autoriteteve drejtuese dhe pedagogëve për</i>

	përmirësime të mëtejshme. Ekziston gjithashtu një proces i qartë për trajtimin e ankesave të studentëve, duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri. GVJ vlerëson se institucionit ka një sistem të qëndrueshëm dhe funksional për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke ndjekur praktikatat të mira në këtë fushë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë (SBC) është një ndër prioritetet e UET (Evidenca Nr. 2. Statuti i UET). Në rregulloren e brendshme (Evidenca Nr. 5. Rregullore UET) përcaktohet se pjesë e strukturave të posaçme për sigurimin e standardeve dhe të cilësisë janë Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore, si dhe Zyra e Kurrikulave. Po ashtu, institucioni zbaton një strategji të posaçme për SBC (Evidenca Nr. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028), në të cilën përcaktohen tërësia e politikave, strukturave dhe procedurave për SBC, në linjë me kuadrin ligjor. Në Manualin e SBC (Evidenca Nr. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë) përcaktohen parimet, procedurat, proceset dhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e të gjithë elementëve të përfshirë në SBC. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZCS) është përgjegjëse për SBC, në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulës. UET ka ngritur Komisionet e SBC, e cila funksionon në nivel fakulteti dhe universiteti.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UET ka ngritur Komisionin e SBC, e cila funksionon në nivel fakulteti dhe universiteti (Evidenca Nr. 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC). KSBC funksionon mbi bazë të parimeve të përcaktuar në statutin e UET, rregulloren e institucionit dhe strategjisë. Përfshirja e studentëve sigurohet përmes të qenurit anëtarë të KSBC (Evidenca Nr. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028), si dhe përmes pjesëmarrjes në mbledhje

dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	të hapura, fokus grupe, sondazhe, etj. Anëtar i KSCB është edhe një ekspert i jashtëm.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se institucioni përdor instrumenta dhe tregues efektiv për sigurimin e cilësisë, të cilat përfshijnë procesin mësimor, programet lëndore, performancën e personelit, vlerësimet, etj. Për sigurimin e jashtëm të cilësisë, UET i është nënshtruar proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit ⁸ , që nga hapja e tij (Evidencat Nr. 54.3., 54.4. Vendime të Bordit të Akreditimit, i parë dhe periodik). GVJ vlerëson si një praktikë të mirë procesin e akreditimit institucional të kryer gjatë vitit akademik 2021-2022, nga Agjencia Britanike pjesë e ENQA, Quality Assurance Agency (Evidencat Nr. 54.6. QAA Certificate of Accreditation; Evidenca Nr. 54.7. VBA Nr. 82 datë 22.09.2023 - Akreditimi Periodik Institucional ASCAL QAA).
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i akteve dhe praktikave të paraqitura në DVV, GVJ konstaton se institucioni, përmes KSBC, ndërmerr në mënyrë periodike aktivitete monitoruese dhe vlerësuese për proceset akademike (Evidencat Nr. 30.9 – 30.12.⁹). KSBC operon mbi bazën e një plani vjetor aktiviteteve (Evidenca Nr. 30.1. Plani veprimi KSBC). Bazuar në rezultatet, KSCB rekomandon detyra të cilat ndiqen nga organet drejtuese dhe vetë komisioni. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në një dokument dhe ndahen me autoritetet përgjegjëse si dhe me pedagogët, përgjegjësin e departamentit, përgjegjësin e grup-lëndës, etj. (Evidenca Nr. 30.12. Shembull_Relacion DMM_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022; Evidenca Nr. 37. Format_i Raporti i Vlerësimit të Programeve të Lendeve)
Konkluzione	<i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka politika dhe struktura të qarta për SBC, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore institucionale. Procesi i sigurimit të cilësisë është i mirëorganizuar dhe realizohet përmes njësive të specializuara, si Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, Zyra e Kurrikulave dhe KSBC, që operon në nivel fakulteti dhe universiteti. Institucioni ka një strategji të posaçme për SBC dhe një sistem të qëndrueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, duke përdorur instrumente dhe tregues të qartë për</i>

⁸ <https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/>

⁹ 30.9. Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset; 30.10. Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve; 30.11. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset; 30.12. Shembull_Relacion DMM_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022

	<i>vlerësimin e programeve të studimit, procesit mësimor dhe performancës së stafit akademik.</i> <i>GVJ vlerëson si praktikë të mirë përfshirjen aktive të studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë përmes anëtarësimit në komisione, fokus grupeve dhe pjesëmarrjes në sondazhe. Po ashtu, institucioni i është nënshtruar proceseve të akreditimit të jashtëm, përfshirë atë të realizuar nga Agjencia Britanike ENQA. Kjo e fundit konsiderohet nga GVJ gjithashtu si një praktikë e mirë. Rezultatet e vlerësimeve analizohen dhe i përcillen autoriteteve drejtuese dhe pedagogëve për përmirësime të mëtejshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe në vijim të vizitës në institucion, GVJ vëren se UET ka në funksion procese të dokumentuara periodike për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Institucioni kryen në mënyrë periodike shqyrtimin dhe dokumentimin e provimeve (Evidencat Nr. 30.5 – 30.8¹⁰), programit lëndor (Evidencat Nr. 30.9 - 30.12¹¹), performancës së pedagogëve, etj. KSBC harton raporte në të cilat përfshin gjetjet dhe masat për përmirësim dhe ia shpërndan organeve drejtuese dhe personelit. Raportet bëhen pjesë e diskutimeve në nivel Rektorati dhe departamenti.

¹⁰ 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet. 30.6. Format raporti për kontrollin e provimeve. 30.7. Shëmbull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet. 30.8. Shëmbull_Raporti për provimet Sem 1_v.a.21-22 - DMM_FEBZH

¹¹ 30.9. Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset. 30.10. Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve. 30.11. Shëmbull_Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset. 30.12. Shëmbull_Relacion DMM_Monitorimi i Silabuseve_Sem I_2021-2022

bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se në raportet e vlerësimit përfshihen problematikat e evidentuara gjatë shqyrtimit, shoqëruar me një analizë të detajuar të secilës problematikë (Evidencat Nr. 30.5 – 30.8 ¹²). Bazë e vlerësimit është përputhshmëria e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë, duke u bazuar në metodologjinë përkatëse të vlerësimit ku përcaktohen kriteret që do përdoren për vlerësim (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; Evidenca nr. 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet; Evidenca Nr. 30.9. Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset). Në analizën vjetore të departamentit përfshihen masat e marra dhe niveli i adresimit të problematikave të evidentuara (Evidenca Nr. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese). Monitorimi i procesit të marrjes së masave bëhet nga KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në SBC.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se cilësia e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” vlerësohet periodikisht me disa metoda të drejtpërdrejta, të cilat adresojnë mësimdhënien, kurrikulën, didaktikën, provimet, detyrat e studentëve, etj. Për këtë, KSBC harton një plan aktiviteteve vjetore (Evidenca Nr. 30.1. Plani veprimi KSBC). Konkretisht, metodat e përdorura janë: • Analiza e cilësisë bazuar në notën mesatare në hyrje dhe dalje (Evidenca Nr. 25. Tabela 21) • Vlerësimi i performancës së personelit akademik përmes monitorimit të leksioneve (Evidenca Nr. 30.16 – 30.17. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu/Shembull) • Analiza dhe vlerësimi i programeve lëndore (Evidenca Nr. 37 – 37.1. Formati_Raporti i Vlerësimit të Programeve të Lendëve/Shembull) • Analizimi i kontributit kërkimor përmes përfshirjes së personelit akademik në projekte kërkimore, angazhimi

¹² 30.5. Metodologjia e punës së KSBC për Provimet. 30.6. Format raporti për kontrollin e provimeve. 30.7. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet. 30.8. Shembull_Raporti për provimet Sem 1_v.a.21-22 - DMM_FEBZH

	në konferenca, publikime, etj. (Evidencat 43.1 – 43.3 ¹³).			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ vëren se institucioni realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike përmes pyetësorëve online (Evidenca Nr. 40.1. Shembull_Vlerësimi nga studentët_online), fokus grupeve (Evidenca Nr. 30.14. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve), mbledhjeve të bordit të punës me të diplomuar (alumni) (Evidenca Nr. 12.2. Axxhenda e takimit me Bordin e Tregut te Punes), mbledhjeve të hapura të departamentit (Evidenca Nr. 12.4. Mbledhje e hapur me studentet), etj. Gjithashtu, aktivitete të tjera që shërbejnë si metoda të tërthorta për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave janë Panairi i Punës (Evidenca Nr. 12.5. Poster Panairi i Punes 2019 -2023), mbledhjet e personelit akademik (Evidenca Nr. 6.1. Shembull_Procesverbal_Mbledhje dekanati FEBZH; Evidenca Nr. 6.2. Shembull_Procesverbal mbledhje departamenti_mbledhje e hapur departamenti me studentë), etj.			
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se UET monitoron dhe vlerëson periodikisht programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe përmirësime të vazhdueshme të programit. Vlerësimi kryhet duke përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Procesi koordinohet dhe monitorohet nga KSBC mbi bazën e një plani veprimi vjetor. Në procesin e vlerësimit të programit të studimit përfshihen edhe studentët e diplomuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi VI.4

¹³ 43.1. Extract Raporti Vjetor 21-22_Projekte UET dhe Kërkimi shkencor FEBZH. 43.2. Extract Raporti Vjetor 22-23_Projekte UET dhe Kërkimi shkencor FEBZH. 43.3. Extract Raporti Vjetor 23-24_Projekte UET dhe Kërkimi shkencor FEBZH.



Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në rregulloren për SBC, pika F.VII.5, përcaktohen strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë). Bazuar në këtë rregullore në UET është ngritur KSBC, e cila përbëhet nga: një anëtar Kryetar i Komisionit, dy përfaqësues lektorë në secilin fakultet, një përfaqësues nga stafi administrativ, dy përfaqësues nga Këshilli Studentor, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm (Evidenca Nr. 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC). Përbërja e KSBC është në përputhje me pikën 5.4 të Strategjisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë (Evidenca Nr. 30.3).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Detyrat dhe përgjegjësitë për SBC janë të përcaktuara në rregulloren për SBC (Evidenca Nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë): • Strukturat hierarkike organizative të përfshira në proceset e monitorimit dhe vlerësimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen në manualët përkatëse. • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, përgjegjëse për zhvillimin e politikave, strategjive, proceseve dhe udhëzimeve SBC, monitorimin e zbatueshmërisë së tyre. Organizon, koordinon dhe mbështet zhvillimin e proceseve të vlerësimit dhe monitorimit. • KSBC, përgjegjëse për vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore, administrative dhe financiare të institucionit. UET ka hartuar dhe zbaton procedura të dokumentuara, si dhe manuale dhe udhëzues të detajuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në të cilat detajohen detyrat dhe përgjegjësitë konkrete sipas tematikës përkatëse.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe	Referuar dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se në KSBC ka anëtar nga njësia bazë dhe njësia kryesore që ofron programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", personel administrativ dhe përfaqësues nga Këshilli Studentor (Evidenca Nr. 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC; Evidenca Nr. 30. Të dhëna për anëtarët e KSBC). Po ashtu, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se në proceset e dokumentuara të sigurimit të cilësisë të analizuar në kriteret e mësipërme (vlerësimet e syllabuseve, vlerësimet e provimeve, etj.) për këtë program studimi, janë të përfshirë anëtarë dhe student të njësisë bazë dhe njësisë kryesore.

studentëve e programit të studimit.				
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se në Kodin e Etikës së UET (Evidenca Nr. 16) përshkruhen parimet e etikës akademike dhe publike, duke garantuar që në proceset e vlerësimit të respektohet integriteti akademik dhe të shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstaton se në përbërje të KSBC ka një ekspert të jashtëm (Evidenca Nr. 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC), i cili jep mendime dhe ekspertizë lidhur me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. Po ashtu, GVJ vëren se kontributi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm jepet edhe përmes veprimtarive të tjera si Panairi i Punës, leksionet e hapura, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione, biznese, shoqëri civile, donatorë, etj. (Evidencat Nr. 12.5; 34; 32; 34.1-34.14; 32.1. ¹⁴)			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se njësitë bazë, njësitë kryesore, personeli akademik, personeli administrativ dhe studentët janë të përfshirë në procesin e SBC, duke kontribuar në arritjen e rezultateve dhe përmirësimin e proceseve akademike dhe administrative. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen qartë në aktet e brendshme të institucionit. Në përbërje të KSBC ka përfaqësues nga studentët dhe një ekspert të jashtëm. Angazhimi i ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm realizohet edhe përmes veprimtarive të tjera si leksione të hapura, panairë, marrëveshje bashkëpunimi, praktika mësimore, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

¹⁴ 12.5. Poster Panairi i Punës 2019 -2023; 34. Marrëveshjeve të Bashkëpunimit UET; 34.1 – 34.14. Marrëveshje bashkëpunimi individuale. 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik, administrativ dhe studentët janë të njohur me politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kuadri rregullator SBC është i aksesueshëm prej tyre. Veprimtaritë SBC janë të publikuara edhe në faqen e internetit (https://uet.edu.al/rreth-uet/), duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga shqyrtimi i RVB dhe pas konsultimit të faqes së internetit, GVJ konstaton se raportet e vlerësimeve të programit të studimit (vlerësimet e brendshme dhe të jashtme) janë të publikuara dhe është respektuar legjislacioni për të dhënat personale, liria dhe etika akademike (https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Siç është evidentuar edhe në kriteret e mësipërme, rezultatet e vlerësimeve ndahen nga KSBC me njësitë dhe organet vendimmarrëse dhe diskutohen në mbledhjet e tyre. Si rezultat i këtyre diskutimeve, sugjerohen masa konkrete për adresimin e problematikave duke hartuar një plan masash konkret. Ky plan masash miratohet nga Senati akademik dhe zbatohet në vitin pasues (Evidenca Nr. 30.1. Plani veprimit KSBC; Evidenca Nr. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028).
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur si dhe pas vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ka qenë subjekt monitorimi dhe vlerësimi për sigurimin e cilësisë dhe se këto procese kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së programit, si p.sh. në përmirësimin e syllabuseve. Angazhimi i personelit akademik të këtij programi studimi në projekte ndërkombëtare dhe veprimtari kërkimore-shkencore, sjell po ashtu përfitime që reflektohen në cilësi të përmirësuar të programit të studimit (Evidencat 43.1 – 43.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të FEBZH; Evidenca Nr. 43. Programi i Madh Kërkimor 2021-2025)
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari	GVJ konstaton se UET organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët, si mbledhjet e Asamblesë së

periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	pedagogëve, takime me studentë dhe departamentin, trajnime të ndryshme (Evidenca Nr. 33. Të dhëna për aktivitete dhe trajnime per stafin dhe studentet), publikime në faqen web, LMS, rrjete sociale, etj., me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e tyre në përmirësimin e programit të studimit.			
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion u konstatua se UET siguron transparencën e politikave dhe strategjive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke i bërë ato të aksesueshme për studentët dhe publikun përmes dokumenteve dhe faqes zyrtare të internetit. Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit publikohen duke respektuar legjislacionin për të dhënat personale dhe etikën akademike. Këto vlerësime shoqërohen me plane masash për përmirësim, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Institucioni monitoron dhe vlerëson ndikimin e këtyre masave në cilësinë e programeve të studimit, duke reflektuar përmirësime konkrete, si në syllabuse dhe përfshirjen e stafit akademik në kërkime shkencore. Gjithashtu, GVJ konstatoi se UET organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e tyre në sigurimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Informatikë Ekonomike" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti European i Tiranës"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Institucioni ka zhvilluar politika, strategji, manuale dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat zbatohen në mënyrë periodike dhe efektive. UET ka ngritur një sistem të strukturuar dhe funksional të sigurimit të cilësisë, duke garantuar një përfshirje të gjerë të personelit akademik, administrativ, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Një praktikë e mirë është kryerja e auditimit të jashtëm nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (Quality Assurance Agency – QAA), duke ofruar një vlerësim objektiv dhe ndihmuar në përmirësimin e mëtejshëm të standardeve akademike.
2. UET ofron një gamë të gjerë shërbimesh për studentët përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, duke i ndihmuar në zhvillimin akademik dhe orientimin në karrierë. Qasja e mësimdhënies me në qendër studentin, është një praktikë e mirë që vlen të përmendet. Një aspekt tjetër pozitiv është angazhimi i studentëve në procese të ndryshme vendimmarrëse dhe akademike, duke bërë që zëri i tyre të merret në konsideratë në mënyrë aktive.
3. Një tjetër pikë e fortë është përfshirja aktive e institucionit në veprimtari akademike dhe projekte të ndryshme. UET organizon dhe merr pjesë rregullisht në panaire, leksione të hapura dhe trajnime për zhvillimin profesional të stafit akademik. Një praktikë shumë e mirë në këtë drejtim është mënyra e funksionimit të Zyrës së Projekteve, e cila luan një rol kyç në ndihmën për aplikimin dhe zbatimin e projekteve, duke lehtësuar ndjeshëm punën e personelit akademik dhe rritur mundësitë për fitimin e projekteve.
4. Universiteti ofron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit, të pajisura me infrastrukturë të përshtatshme, pajisje elektronike dhe mjete didaktike që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies. Një aspekt pozitiv për t'u përmendur është qasja e zhvillimit të orëve të mësimi kryesisht në laboratorë, duke nxitur jo vetëm aspektin teorik, por edhe atë praktik, çka ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi konkrete dhe të përgatiten më mirë për tregun e punës.
5. Përdorimi i një sistemi elektronik të menaxhimit të informacionit (LMS), i cili është me module të integruar mundëson një komunikim efektiv interaktiv midis studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ të universitetit, duke shpërndarë informacionin në kohër reale dhe duke lehtësuar administrimin e tij.
6. Përmbajtja e kurrikulës së programit, rishikimi i vazhdueshëm i syllabuseve, dhe ofrimi i programit në gjuhën shqip dhe anglisht e bën ata të ketë avantazh konkurrues dhe të përshtatshëm për nevojat e tregut të punës.
7. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi të shumta në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit.



Pika të dobëta

1. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, ofrues i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", nuk ka si pjesë të njësive personelin akademik me profil në shkencat kompjuterike dhe mbështetet tërësisht në personelin e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës për realizimin e lëndëve të profilit informatikë, që zënë dhe peshën më të madhe të programit mësimor. Kjo ndikon në administrimin dhe zhvillimin organik të programit "Informatikë Ekonomike".
2. Në bibliotekë mungon literatura e detyrueshme e specifikuar në syllabuset e lëndës, ndërsa fondi i librave që i përgjigjet 5 viteve të fundit është i pakët, veçanërisht në fushën e teknologjisë së informacionit.
3. Literatura e detyruar për disa nga lëndët, sipas syllabuseve të tyre, i përket më shumë se 10-15 viteve të fundit.
4. Faqja zyrtare e internetit të institucionit nuk përmban të gjitha detajet e nevojshme për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" dhe procedurat akademike (pranimi, transferimi, njohja e studimeve, vlerësimi i dijes, etj.), duke lënë disa aspekte të paqarta për studentët që janë të interesuar për programin.
5. Procesi i kontrollit periodik të përvitshëm të të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarinë mësimore, sistemin e brendshëm, etj.) nuk është i dokumentuar, duke krijuar një boshllëk në procedurat e menaxhimit që mund të ndikojë në sigurimin e transparencës dhe efikasitetit të procesit.
6. Koordinator i programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është zgjedhur një pedagog efektiv i departamentit përgjegjës për këtë program studimi, por që nuk është pjesë e stafit mësimdhënës në këtë program. Kjo gjë e bën të vështirë angazhimin e tij në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të koordinatorit.
7. Përsa i përket Provim të Përgjithshëm Përfundimtar, në përfundim të studimeve, nuk ka një referencë apo ndonjë dokument ku të përcaktohen rregullat për mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm që administron këtë provim ose mënyrën se si hartohet teza.

Rekomandime

1. Pajisja e Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut me personelin akademik me specializim në shkencat kompjuterike, si pjesë përbërëse të njësive bazë, në mënyrë që programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" të administrohet dhe zhvillohet më efektivisht brenda Departamentit.
2. Biblioteka të pajiset të paktën me literaturën e detyrueshme dhe të jetë e disponueshme dhe e aksesueshme për studentët. Të shtohet fondi i bibliotekës në funksion të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", kryesisht me literaturë të 5 viteve të fundit në gjuhën shqipe dhe të huaj.
3. GVJ rekomandon përditësimin e literaturës me literaturë të 5 viteve të fundit për ato lëndë që nuk e kanë.




4. Faqja zyrtare e internetit të institucionit të plotësohet me informacion të përditësuar për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" dhe procedurat akademike, duke siguruar që të gjithë të interesuarit të kenë mundësi të kenë një kuptim të plotë të mundësive dhe kërkesave përkatëse.
5. Realizimi dhe dokumentimi në mënyrë periodike i kontrollit të proceseve menaxheriale për të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin (sekretarinë mësimore, sistemin e brendshëm, etj). Kjo do të sigurojë një monitorim të vazhdueshëm të proceseve dhe do të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në menaxhimin e programeve dhe aktiviteteve akademike.
6. GVJ rekomandon që koordinatori të jetë i lidhur ngushtësisht me këtë program studimi, të jetë pjesë e stafit që jep mësim në të, për të qenë më pranë përmbajtjes së programit dhe studentëve të tij.
7. GVJ rekomandon hartimin e Rregullores së Provimit Final, e cila duhet ti vendoset në dispozicion studentëve së bashku me Rregulloren për Punimin e Diplomës.
8. Bazur tek Urdhër Nr. 226, Datë 19.07.2021 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike", në Universitetin Europian të Tiranës, ky program është liçensuar me 180 kredite (ECTS), ndërkohë që sipas Planit Mësimor ky program ofrohet me 181 kredite (ECTS). Rekomandojmë që të rishikohet shpërndarja e krediteve në Planin Mësimor në mënyrë që në total numri i krediteve të jetë në përputhje me Urdhërin e hapjes së këtij programi.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Business Informatics" provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The institution has developed clear policies, strategies, manuals, and procedures for Internal Quality Assurance, which are implemented periodically and effectively. UET has established a structured and functional quality assurance system, ensuring broad participation from academic and administrative staff, students, and external collaborators. A notable strength is the external audit conducted by the British Quality Assurance Agency (QAA), which provides objective assessments and support the continuous improvement of academic standards.
2. UET offers a comprehensive range of student services through the Career Counseling and Student Care Office, helping students with academic development and career guidance. The student-centered learning approach stands out as an effective practice. Another positive aspect is the active involvement of students in decision-making and academic processes, ensuring that their perspectives are valued and taken into account.
3. The institution's active engagement in academic activities and various projects is another key strength. UET regularly organizes and participates in fairs, open lectures, and professional development training for academic staff. A particularly commendable practice is the role of the Projects Office, which provides crucial support for project



applications and implementation, significantly easing the workload of academic staff and increasing the institution's success in securing project funding.

4. The university offers well-equipped learning environments with good infrastructure, electronic tools, and didactic resources that enhance the quality of teaching and learning. A noteworthy aspect is the emphasis on laboratory-based classes, which reinforces both theoretical and practical learning, helping students develop concrete skills and better prepare for the job market.
5. The use of an integrated module electronic management system (LMS) enables effective interactive communication between students, academic staff, and the university's administrative staff, by distributing information in real-time and facilitating its management.
6. The content of the program curriculum, the continuous revision of syllabi, and the offering of the program in both Albanian and English give it a competitive advantage and make it suitable for the needs of the job market.
7. The institution has numerous collaboration agreements aimed at developing professional practices for students in line with the needs of the study program.

Weaknesses

1. The Department of Management and Marketing, which offers the Bachelor's program in "Business Informatics", does not have academic staff specialized in computer science within its unit. Instead, it relies entirely on the staff of the Faculty of Engineering, Informatics, and Architecture to deliver courses related to informatics, which constitute the majority of the curriculum. This affects the administration and organic development of the "Business Informatics" program.
2. The library lacks the mandatory literature specified in course syllabi, and the collection of books from the last five years is limited, particularly in the field of information technology.
3. The mandatory literature for some of the subjects, according to their syllabi, dates back more than 10–15 years.
4. The institution's official website does not provide all the necessary details regarding the "Business Informatics" Bachelor's program and academic procedures (admission, transfer, recognition of studies, assessment of knowledge, etc.), leaving certain aspects unclear for prospective students.
5. The annual periodic control process of all management units (teaching secretariat, internal systems, etc.) is not documented, creating a gap in management procedures that may impact the transparency and efficiency of the process.
6. The coordinator of the Bachelor's study program in "Business Informatics" has been selected from among the full-time lecturers of the department responsible for this program, but he is not part of the teaching staff involved in the program. This makes it difficult for him to effectively fulfill the duties and responsibilities of the coordinator.



7. Regarding the Final Comprehensive Exam, at the end of studies, there is no reference or official document that defines the rules governing the functioning of the special committee responsible for administering this exam, or the procedures of the test design.

Recommendation

1. The Department of Management and Marketing should be equipped with academic staff specialized in computer science as part of its internal unit, ensuring that the Bachelor program in "Business Informatics" is administered and developed more effectively within the department.
2. The library should be equipped with at least the mandatory literature, ensuring it is available and accessible to students. Additionally, the library's collection should be expanded to support the Bachelor program in "Business Informatics", particularly with literature from the last five years in both Albanian and foreign languages.
3. The External Evaluation Group recommends updating the literature with sources from the last five years for those subjects that do not currently have it.
4. The institution's official website should be updated with comprehensive and up-to-date information about the Bachelor program in "Business Informatics" and academic procedures, ensuring that all prospective students have a clear understanding of the available opportunities and relevant requirements.
5. Implement and document the management process controls for all responsible units (teaching secretariat, internal systems, etc.). This will provide continuous monitoring of processes and contribute to improving efficiency and transparency in the management of academic programs and activities.
6. The External Evaluation Group recommends that the coordinator be closely involved with this study program and be part of the teaching staff within it, in order to be more engaged with the program's content and its students.
7. The External Evaluation Group recommends the drafting of Regulations for the Final Exam, which should be made available to students along with the Thesis Guidelines.
8. According to Order No. 226, dated 19.07.2021, "On the opening of the first cycle study program 'Bachelor' in "Business Informatics" at the European University of Tirana," this program is licensed with 180 ECTS credits. However, according to the Curriculum Plan, the program is offered with 181 ECTS credits. We recommend reviewing the distribution of credits in the Curriculum Plan so that the total number of credits is in accordance with the Order for the opening of this program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

